



Abdurmexhid Zendani

KURANI
ËSHTE

i Vërteti



*Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshiruesit!*

KUR'ANI ËSHTË I VËRTETË

AbdulMexhid ez-Zindani

Botuar nga: botues privat

© Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Ajni Sinani

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	4
“AI, KUR’ANI ËSHTË I VËRTETË?”	4
PJESA E PARË.....	7
ETAPAT E KRIJIMIT TË NJERIUT (A)	7
PJESA E DYTË.....	14
ETAPAT E KRIJIMIT TË NJERIUT (B).....	14
PJESA E TRETË.....	21
RRETH OENDRAVE NERVORE NË LËKURË DHE PËRSHKRIMIT TE TYRE KUR'ANOR	21
PJESA E KATËRT'	26
RRETH THËNJJEVE TE PROF. KRONER NË LIDHJE ME TE DHËNAT KUR'ANORE RRETH, GJEOLIGJISË DHE FORMIMIT TE TRUPAVE	26
PJESA E PESTË.....	30
PËRSHKTIIMI I JASHTËM DHE I BRENDSSHËM I ETAPAVE TE KRIJIMIT TE NJERIUT NË KUR'AN	30
PJESA E GJASHTË.....	37
RRETH PËRPUTHSHMËRISË SE DISA ZBULIMEVE NË EKZISTENCË ME TE DHËNAT KUR'ANORE	37
PJESA E SHTATË ISLAMI DHE SHKENCA.....	41
PJESA E TETË.....	46
ARGUMENTET QË GJENDEN NE DETE DHE OQEA NE	46
PJESA E NËNTË	51
SHFAQJA E SËMUNDJEVE DHE EPIDEMIVE ME PARAOITJEN E AMORALITETIT'	51
PJESA E DHJETË.....	55

TE DHËNA NATYRORE DHE GJEOGRAFIKE	55
PJESA E NJËMBËDHJETË KODRAT.....	60
PJESA E DYMBËDHJETË.....	65
TE VËRTETA ASTRONOMIKE.....	65
PJESA E TREMBËDHJETË ETAPAT EMBRIOLOGJIKE.....	70
PJESA E KATËRMBËDHJETË THELLËSITË DETARE DHE OOEANIKE	74
PJESA E PESËMBËDHJETË	78
FENOMENET DETARE NE MES ZBULIMEVE SHKENCORE DHE AJETEVE KUR'ANORE.....	78
PJESË TE ZGJEDHURA	82
PASTHËNIE.....	84

“Qoftë lavdëruar nata e bekuar, në të cilin Pejgamberit të Zotit iu shpall, nga lart, Kur’ani me përkryeshmërinë e tij”

Gëte

PARATHËNIE

“Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet tona në horizonte dhe në vetën e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani), është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitarë për çdo gjë?” (Fussilet, 53)

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botëve!

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi Muhammedin a.s., familjen, shokët dhe gjithë ata që ndjekin rrugën e tij, deri në ditën e gjykimit.

Këto janë debate shkencore të zhvilluara me katërmbëdhjetë dijetarë bashkëkohorë të sferave të ndryshme, të cilat i kam përmbledhur në një videokasetë me titull:

“AI, KUR’ANI ËSHTË I VËRTETË!”

Në këtë libër që po u ofroj lexuesve do të paraqesim në vazhdim debatet e zhvilluara, në mënyrë që të njihen të vërtetat shkencore rreth të cilave flasin disa ajete Kur’anore. Ato dëshmojnë se Islami porosit dhe urdhëron përvetësimin e dijes dhe se shpallja hyjnore nuk mund të bie ndesh kurrësi me të vërtetat e pakontestueshme shkencore.

Shkencëtarët me të cilët i zhvilluam këto debate, nuk i përkasin besimit islam. Sukseset që ata kanë arritur nëpërmjet studimeve

dhe kërkimeve të tyre, bëjnë që ata të kenë një ndjenjë krenarie dhe vetëkënaqësie, por kur u thuhet se, për këto rezultate Kur'ani ka folur hapur apo në mënyrë indirekte, para më shumë se 1400 vjetësh, ata mbesin të mahnitur nga habia dhe çudia.

Ajo që është e përbashkët në të gjitha deklaratat që ata bënë, pasi u njohën me këto të dhëna, është fakti se Kur'ani s'mund të jetë rezultat i mendjes së njeriut. Disa prej tyre deklaruan hapur se Muhammedi a.s. është i dërguar i Zotit, e disa të tjerë tanë Shehadetin, duke pranuar Allahun për Zot, Muhammedin a.s. për pejgamber dhe Kur'anin për libër të Zotit. Fakti se këta dijetarë të mëdhenjë, në fushat përkatëse, e pranojnë këtë, është argument i fortë nxitës për shkencëtarët tjerë të të njejtit nivel, e aq më tepër për ata njerëz që qëndrojnë më poshtë sa i përket nivelit të tyre shkencor. S'ka dyshim se këta, u hapin atyre dyert e mbyllura dhe i drejojnë në rrugën drejt besimit tek Allahu, Zotit të botëve. Çfarë peshe mund të kenë fjalët e mohuesve të besimit, pas shqarimit të argumentit, bindshmërisë së të argumentuarit dhe deklarimit të Shehadetit nga ana e këtyre shkencëtarëve? Të vërtetën e ka thënë Allahu xh.sh. kur thotë:

“Thuaj: më tregoni mua se nëse ai (Kur'ani) është prej Allahut, e ju e mohuat (si do të jetë puna juaj), ndërsa një dëshmitar nga beni israilët e deshmoi si të tillë (të zbritur prej Allahut) dhe i besoi, kurse ju bëtë kryelartësi (a nuk jeni zullumqarë?) e s'ka dyshim se Allahu një popull që është mizor, nuk e udhëzon në rrugën e shpëtimit”. (El Ahkaf, 10)

Debatet dhe takimet direkte që kemi pasur me këta shkencëtarë janë regjistruar dhe në videokasetë, gjë që ndikon akoma më shumë tek shikuesi...

Nisur nga dëshira e mirë dhe për t'iu përgjigjur kërkesave dhe dëshirave të shumta, vendosëm t'i botojmë këto debate në këtë libër të vogël duke iu përmbajtur me përpikëri tekstit original (

të videokasetës), në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi dhe leximi i tij, duke shpresuar se me ndihmën e Allahut xh.sh., ky libër të bëhet shkak për të udhëzuar në rrugën e drejtë. Ne nuk kërkojmë gjë tjetër, veçse të përmirësojmë, me aq sa kemi munësi, gjë që mund tsa arrijmë vetëm me ndihmën e Allahut xh.sh. atij i mbështetemi, tek Ai do të kthehemi dhe vetëm Ai është i denjë për çdo falënderim.

PJESA E PARË

Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju.

ETAPAT E KRIJIMIT TË NJERIUT (A)

Allahu e dërgoi Muhammedin a.s. (alejhis selam) peygamber për mbarë njerëzimin, ashtu siç thotë Allahu i madhëruar:

“Ty Muhammed, të dërguam mëshirë për të gjitha botërat” (El Enbija, 107)

Muhammedi a.s. u dërgua peygamber për nomadët e shkretëtirës. Ai u dërgua edhe për dijetarët e kohës sonë. U dërgua peygamber për njerëzit e intelektëve të ndryshme. Peygamberët që u dërguan para Muhammedit a.s. iu dërguan vetëm popullit të tyre. Allahu në Kur'an thotë:

“Çdo popull pati udhëzues, peygamber.” (Err Rr’ad, 7)

Ndërkaq, misioni i Muhammedit a.s. për mbarë njerëzimin. Prandaj Allahu i madhëruar mrekullinë e Muhammedit a.s. e veçoi nga mrekullitë e peygamberëve të mëparshëm.

Mrekullitë e peygamberëve para Muhammedit ﷺ i shihnin vetëm bashkëkohësit e tyre. Kohë pas kohe, sa herë që njerëzit largoheshin nga besimi i vërtetë, Allahu u dërgonte atyre peygamber, duke iu dhënë mrekulli, që ti ftonin njerëzit në besimin në Një Zot të Vetëm, besimin në Allah. Muhammedi ﷺ është peygamber i fundit i Allahut deri në Ditën e gjykimit. Dhe Allahu bëri që mrekullia e Tij të jetë e përhershme.

Nëse kërkojmë nga ithtarët e feve të tjera që të na tregojnë mrekullinë e Musait apo Isait, ata do të përgjigjen se s’munden.

Ata s'mund t na tregojnë shkopin e Musait dhe as të na tregojnë Isain se si i ngjallte të vdekurit me emrin e Allahut.

Ata do të thonë se ne këto i besojmë duke iu përmbajtur shënimeve historike.

E nëse pyetet myslimani për mrekullinë më të madhe të Muhammedit ﷺ, ai do të përgjigjet se është Kur'ani i shenjtë.

Ky është Kur'ani, mrekullia e përherëshme. Ai gjendet në duart tona dhe secili mund ta studiojë atë që gjendet në të.

Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“Thuaj, cili send ka dëshminë më të madhe? Thuaj: Allahu është dëshmuar mes nesh e jush. Mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ia tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet”. (El En'am, 19)

Mrekullia e Kur'anit është dija dhe shkenca që gjendet në të. Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“Po, Allahu dëshmon për atë që ta zbriti ty, Atë t'a zbriti sipas dijes së Vet”. (En Nisa, 166)

Bashkëkohësit tanë, studiuesit, profesorët e universiteteve dhe gjenitë e mendimit njerëzor, mund ta studiojnë dijen dhe shkencën që gjendet në Librin e Allahut. Në kohën tonë dijetarët kanë ecur shumë para në të studiuarit e universit.

Edhe Kur'ani flet mbi universin dhe qenien njerëzore. Cili është rezultati?

Ky është Keeth More (Kith Mur), njëri nga dijetarët më të mëdhenjë në anatomi dhe embriologji.

Nga ai u kërkua që të jap mendimin e tij shkencor rreth vargjeve Kur'anore dhe thënjeve të Muhammedit ﷺ që i përkasin sferës së specializimit të tij.

Profesor Mur, është autor i këtij libri, (The Developing Human, clinically oriented embryology, Keith L. Moore). Ky libër është përkthyer në tetë gjuhë: gjermane, ruse, japoneze, kineze, italiane, portugeze, angleze dhe bosnjake.

Kur kërkuam nga ai të jap mendimin e tij mbi disa vargje kur'anore dhe thënje të Muhammedit ﷺ që kanë të bëjnë me fushën e specializimit të tij, i befasuar dhe i mahnitur prof. Mur tha:

“Si është e mundur që Muhammedi para 1400 vitesh t’i përshkruaj kaq saktësisht fazat e zhvillimit të embrionit në mitrën e nënës, gjë që u zbulua nga shkencë baskëkohore, vetëm para 30 vitesh?!”

Mahnitja e tij së shpejti u shndërrua në kureshtje.

Ai i paraqiti mendimet e tij në disa simpoziume shkencore dhe mbajti ligjeratën me titull “Përputhshmëria në mes Embriologjisë dhe asaj që gjendet në Kur’an dhe Sunnet”.

Ky është doktor Abdullah Nasifi, ish-dekani i universitetit të mbretit Abdul Aziz. Ai na prezanton prof. Moore për të mbajtur ligjeratën e tij: “Ligjeruesi ynë i sotëm është doktor Keith Moore, profesor i anatomisë dhe embriologjisë në universitetin e Torontos, në Kanada. Ai evoloi gradualisht derisa arriti në këtë shkallë. Në fillim ai punoi 11 vjet në universitetin Lina Peg, në perëndim të Kanadasë. 6 vjet më parë u bë përgjegjës i anatomisë dhe embriologjisë në universitetin e Torontos.

Ka udhëhequr shumë shoqata ndërkombëtare siç është shoqata e dijetarëve të anatomisë dhe embriologjisë në Kanada dhe Amerikë, shoqata e dijetarëve të biologjisë ku përfshihen edhe anatomia, embriologjia, biokimia etj. Është zgjedhur anëtarë i akademisë ndërkombëtare për biologji, anëtarë në shoqatën e anatomisë për Amerikën e Veriut dhe atë Latine.

Ka shkruar një numër librash e mes tyre disa libra në anatomi dhe embriologji. Ka botuar tetë libra që konsiderohen manualë për studentët e mjeksisë, të cilat janë përkthyer në gjashtë gjuhë: italiane, gjermane, portugeze, spanjolle, greka dhe kineze.”

Profesori Keith Moore thotë:

“Kam kënaqësinë që marr pjesë në shpjegimin e vargjeve kur'anore dhe thënjeve të Muhammedit ﷺ, që flasin mbi krijimin e embrionit. Jam plotësisht i bindur, se këto fakte, Muhammedit i kanë ardhur nga Zoti, sepse këto informacione shkencore, shkenca i zbuloi kohët e fundit pas një pune shumë të lodhshme. Dhe ky është fakt bindës për mua, se Muhammedi është i dërguar i Zotit”.

Mendoni mbi atë që tha ky profesor i madh, i cili është ndër dijetarët më të famshëm botërorë në shkencën e embriologjisë.

Prof. Keith Moore kur i studioi vargjet e kur'anore, që kanë të bëjnë me sferën e specializimit të tij, tha:

“Gjithsesi Muhammedi duhet të jetë i dërguar i Zotit”.

Prof. Moore kur e pa shushunjën që gjendet në moçale dhe e krahasoi me embrionin në etapën (që Kur'ani e përshkruan) “*gjak i ngjizur*”,- “*alaka*“, gjeti ngjajshmëri të madhe mes tyre. Pastaj tha:

“Vërtetë embrioni në etapën gjak i ngjizur i përngjan plotësisht kësaj shushunje”.

Më pas, ai solli vizatimin e embrionit në etapën alakah dhe , pasi e vuri pranë një fotografie të kësaj shushunje moçalore, bëri një krahasim sqarues midis tyre dhe këtë ia paraqiti mjekëve në disa simpoziume shkencore, sikurse shihet në fig. 1. (a,b).

Prof. Keith Moore gjithashtu sqaroi se embrioni në këtë etapë është i ngjitur në mitrën e nënës, gjë e cila kuptohet edhe nga

vetë fjala arabe “alakah”, që nënkupton “diçka që ngjitet”.




fig. 1

Në këtë figurë shihet ngjajshmëria në mes shushunjës (alakah) dhe embrionit të njeriut në etapën “gjak i ngjizur” të cilin Zoti xh.sh. e emroi “alakah”.

Pra, fjala “alakah” e përmendur në Kur’anin e shenjtë, nënkupton njëkohësisht edhe gjakun e mpiksur, edhe diçka që varet e ngjitet.

Prof. Moore gjithashtu thotë se, kur embrioni gjendet në etapën “gjak i ngjizur”, gjaku është mbyllur në enën e tij, para se të kryhet mbështjellja e embrionit me mbështjellësin e tij. Kështu embrioni i ngjan “gjakut të ngjizur”.

Pra, fjala kur’anore “alakah” përfshinë të gjitha cilësitë e embrionit. Kush e informoi Muhammedin ﷺ për këtë?

Prof. Moore flet edhe mbi embrionin, kur ai kalon në etapën tjetër, të cilën Kur’ani e përshkruan me fjalën “mudga”, që do të thotë “mish i përtypur”.

Ai solli një copë balte të tharë dhe e kafshoi me dhëmbë. Pastaj solli një fotografi të embrionit dhe bëri krahasimin në mes tyre, ku u pa qartë se vërtetë embrioni i ngjante plotësisht mishit të përtypur “mudga”. Fig.2.



fig. 2

Shumë revista kanadeze botuan rezultatet shkencore të prof. Moore. Kohët e fundit prof. Moore shfaqti në TV kanadez serialin me tre pjesë mbi përputhshmërinë mes asaj që ka thënë Kur’ani famëlartë, para 1400 vitesh dhe asaj që ka zbuluar shkenca bashkëkohore sot.

Pastaj prof. Moore-it i bëhet pyetja: Profesor besoni ju se Kur’ani është fjalë e Zotit? Ai përgjigjet: *“Nuk gjej ndonjë vështirësi që ta pranoj këtë”*.

Më pas i bëhet pyetja tjetër: “Si e besoni Muhammedin ﷺ në kohën, kur ju besoni edhe Isain”? Ai përgjigjet: *“Jam i bindur se që të dy ata janë të së njejtës shkollë”*.

Pra, dijetarët botërorë në kohën tonë, janë në gjendje të provojnë se ky libër është zbritur nga Allahu.

Ashtu siç thotë i Lartëmadhëruari:

“Po, Allahu dëshmon për atë që ta zbriti ty, atë ta zbriti sipas dijes së Vet.”

Pra, ata e dinë se Muhammedi ﷺ është i dërguar i fundit i Allahut.
“Në emër të Allahut, Bëmirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit!”
(En Nisa, 166)

“E atyre që u është dhënë dija, e dinë se kjo që të është shpallur nga Zoti yt, është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e të Gjithëfuqishmit dhe të Lavdëruarit.” (Sebe’, 6)

PJESA E DYTË

ETAPAT E KRIJIMIT TË NJERIUT (B)

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Ky libër (The Developing Human, Clinically Oriented Embryology) është manual shkencor që është bazë në shkencën e mjeksisë botërore. Është prkthyer në tetë gjuhë. Autori i tij është prof. Keith Moore (Kith Mur). Kur në Amerikë u formua një komision për të zgjedhur librin më të mirë në botë të shkruar prej një autori, ky libër u zgjodh më i miri.

U takuam me autorin e këtij libri. Atij i treguam shumë vargje kur'anore dhe thënje të Muhammedit ﷺ të cilat kanë të bëjnë me fushën e specializimit të tij, me shkencën e embriologjisë.

Ai u pajtua me ato që i treguam. Pastaj i thamë: *Profesor ju në librin tuaj keni përmendur Mesjetën, keni thënë se në atë kohë shkenca e embriologjisë s'ka qenë e zhvilluar dhe se është ditur shumë pak mbi të. Në kohën kur tek ju mbizotëronte errësira e Mesjetës, në gadishullin arabik u shpall Kur'ani i shenjtë.*

Muhammedi ﷺ njerëzve u transmetoi fjalën e Zotit. Veç të dhënave të tjera shkencore, në Kur'an gjejmë edhe përshkrimin e përpiktë të krijimit të njeiut dhe etapat në të cilat kalon embrioni.

Profesor ju jeni shkencëtarë me me famë botërore, pse nuk u treguat objektiv dhe t'i shkruanit këto të vërteta në librin tuaj?!

Ai u përgjigj: “Faktet janë tej ju, na i ofroni ato”.

Ne iu përgjigjem kërkesës së tij. Profesori e mbajti fjalën dhe u tregua i guximshëm dhe kështu në ribotimin e tretë ai i vendosi citatet kur'anore. Ky botim është përkthyer në tetë gjuhë dhe është shpërndarë në mbarë botën. Këtë e lexojnë shkencëtarët më me emër që zotërojnë gjuhët: angleze, ruse, kineze, japoneze, gjermane, italiane, portugeze dhe boshnjake.

Pra, dijetarët e mëdhenjë, që flasin këto gjuhë, tani lexojnë shtesat e bëra nga doktor Keith Moore, në këtë ribotim.


Prof. Moore, në librin e tij me titull “Shekujt e mesjetës”, veç të tjerash shkruan:

“Përparimi i shkencës në Mesjetë, ishte shumë i ngadalshëm, dhe në lidhje me shkencën e embriologjisë pothuajse nuk dihej asgjë.

Ndërkaq në Kur'anin famëlartë, librin e shenjtë të myslimanëve, përmendet se njeriu krijohet nga përzierja e tajitjeve të mashkullit dhe femrës. Në Kur'an ka shumë vargje, ku aludohet në atë se njeriu krijohet nga një pikë sperme dhe tregohet se ajo vendoset në mitrën e femrës si një farë gjashtë ditëshe. Është i njohur fakti se veza e fekunduar, pasi ka filluar të ndahet, fillon të zhvillohet 6 ditë pas fekondimit. Kur'ani i shenjtë thotë gjithashtu se sperma zhvillohet dhe bëhet gjak i ngjizur, që në gjuhë arabe përshkruhet me fjalën “alakah”.

Veza e fekunduar, pasi ka filluar të ndahet, i përngjan shushunjës dhe në këtë etapë mund të shihet forma e embrionit.

fig. 3



- a- shushunja moçalike (alekah)
- b- embrioni në ditët 24-25 në etapën "gjahu i ngjizur" (alekah)

Në fig. 3. tek vizatimi a dhe b shihet ngjajshmëria midis embrionit në etapën që Kur'ani e përshkruan me fjalën “alakah”, që nënkupton “gjakun e ngjizur” dhe shushunjën moçalike.

Kurse forma e embrionit, në etapën që Kur'ani e përshkruan me fjalën “mudgah”, që do të thotë “copë e mishi e përtypur”, i përngjan një sendi të përtypur në formë çamçakezi, siç shihet në figurën 4.



fig. 4

Kur e shohim këtë figurë, fitohet bindja se në të shohim gjurmët e dhëmbëve që e kanë përtypur. Pasi të kalojnë 40 ose 42 ditë, embrioni merr formën e njeriut dhe nuk i përngjan më embrionit të kafshës, sepse embrioni i njeriut në këtë periudhë fillon të fitojë veçoritë e njeriut, siç shihet në fig. 5.




fig. 5

Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë:

“Ai u krijoi juve në barqet e nënave tuaja, krijim pas krijimi, në tri errësira”. (Ez Zumer, 6)

Ky varg Kur'anor aludon në atë se embrioni zhvillohet në brendi të tre mbështjellësve të errët, që janë:

1. Shtresa e jashtme e barkut të femrës;
2. Shtresa uterinare;
3. Membrana amniokorionike.

Për shkak të hapsirës, nuk mund të diskutojmë rreth disa referencave të tjera, të cilat janë paraqitur në Kur'anin e shenjtë dhe që kanë të bëjnë me zhvillimin embrional të njeriut”.

Ky është artikuli që shkruajti prof. Keith Moore, gjatë studimit të tij shkencor, i cili është shpërndarë në mbarë botën. Falenderimi i takon Allahut.

Prof. Moore, u bind gjithashtu se ndarjet e tanishme në shkencën botërore, rreth etapave të zhvillimit të embrionit në mitrën e nënës janë të ndërlikuara dhe të pakuptueshme dhe nuk ndihmojnë aspak në kuptimin e etapave të embrionit, sepse kjo ndarje bazohet në numra, si etapa nr.1, etapa nr.2, nr.3, nr.4, nr.5 etj.

Ndarja që është përmendur në Kur'an nuk bazohet në numra, por bazohet në format e dalluara dhe të qarta. Në librin e Zotit, në Kur'anin e shenjtë, ndarja përshkruhet me fjalë, si: farë, gjak i ngjizur (alakah), copë mishi (mudgah), eshtra, veshja e eshtrave me mish dhe formimi i krijesës.

Për këtë ndarje kur'anore, e cila bazohet në forma të caktuara, të cilat dallohen nga njëra tjetra, prof. Moore thotë se: “*Është një*

ndarje e përsosur shkencore, e lehtë, e kuptueshme dhe e dobishme”.

Në një simpozium shkencor ai tha:

“Embrioni në mitrën e nënës është i mrojtur nga tre mbështjellës ose tri shtresa:

- 1.Shtresa e jashtme e barkut të femrës;
- 2.Shtresa uterinare;
- 3.Membrana amnikorionike.



Sikurse shihet në fig. 6.

fig. 6

Etapat e zhvillimit embrional të njeriut janë të ndërlukuara për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që pëson ai. Prandaj tani ekziston mundësia që të institucionalizohet një rregull i ri për përshkrimin e e etapave të embrionit duke përdorur termat dhe kuptimet që janë përdorur në Kur'an dhe Sunnet. Ky rregull i ri dallohet për nga thjeshtësia, saktësia dhe përputhshmëria me embriologjinë e sotme. Studimet e shumta të Kur'anit dhe Sunnetit, gjatë katër viteve të fundit, bënë të mundur zbulimin e shumë të rejave rreth embrionit, para të cilave habitet mendja njerëzore. Sipas historisë së shkencës embriologjike, është e qartë se në shekullin e VII, nuk është ditur asgjë në lidhje me etapat e embrionit, të cilat arritën të zbulohen në shek. e XX, prandaj përshkrimi i etapave të embrionit në Kur'anin e shenjtë,

nuk është bazuar në njohuritë shkencore të shek. të 7-të.

Përfundimi i vetëm logjik është se këto përshkrime Muhammedit ﷺ i janë shpallur nga Zoti, sepse ai nuk mundi t'i dinte kurrësi këto të vërteta të hollësishme, kur dihet se nuk dinte madje as shkrim e lexim."

Pastaj doktor Murit i thamë: Ajo që thatë ju është e vërtetë, por nga faktet e Kur'anit dhe Sunnetit, në lëmin e shkencës së embriologjisë, juve u është vënë në dispozicion pak. Pse nuk tregoheni objektiv duke e zgjeruar këtë sferë shkencore me sqarimin e të gjitha citateve kur'anore dhe haditheve, të cilat kanë të bëjnë me fushën e specializimit tuaj?

ProF Mur tha: *"Unë kam shkruar disa shkrime dhe i kam radhitur në vende të përshtatshme në këtë libër shkencor, që ka të bëjë me embriologjinë.*

Ndërkaq që nga ky moment ju autorizoj juve që të shtoni në librin tim këto shtesa islame duke përfshirë të gjitha citatat kur'anore dhe hadithet rreth të cilave kemi biseduar dhe diskutuar, duke i vendosur ato në vende të përshtatshme. Sqaroni aspektet shkencore të Kur'anit në këtë libër." Unë e bëra një gjë të tillë.

Pastaj doktor Mur shkroi një parathënie në lidhje me këto shtesa islame dhe ky është libri të cilin e propozoi vetë doktor Kith Mur.

Ne kemi kontrolluar çdo faqe, në të cilën ka të dhëna shkencore rreth embrionit, dhe në to kemi vendosur citate kur'anore dhe thënie të Muhammedit ﷺ, të cilat kanë të bëjnë me ato të dhëna shkencore.

Ne sot jemi dëshmitarë se tek mendjet më të ndritura njerëzore po arrihet zhdukja e paragjykimeve dhe e urrejtjes ndaj Islamit.

"Në emër të Allahut, Bamireshit të Përgjithshëm, Mëshiruesit"

"E atyre që u është dhënë dija, e dine se kjo që të është shpallur nga Zoti yt, është e vërtetë dhe udhëzon ne rrugën e ti! Gjithëfuqishmit dhe te Lavdëruarit" (Sebe,6)

PJESA E TRETË RRETH OENDRAVE NERVORE NË LËKURË DHE PËRSHKRIMIT TE TYRE KUR'ANOR

S'ka Zot tjetër përveç Allahut, Muhammedi është a dërguari i Tij"

Me këto fjalë prof. Taxhasun deklaroi pranimin e fesë Islame. Kjo ndodhi në simpoziumin e tetë të mjekësisë në Riad, në Arabinë Saudite.

Ky është prof. Taxhatan Taxhasun, përgjegjës i anatomisë dhe embriologjisë në universitetin Shajng Maj në Tajlandë dhe njëherësh është dekan i fakultetit të mjekësisë në këtë universitet.

Kontaktin e parë me të e patëm, kur i treguam disa vargje kur'anore dhe thënie të Muhammedit ﷺ, të cilat kanë të bëjnë me sferën e specializimit të tij në shkencën e anatomisë. Pasi ia treguam ato, ai tha: *"Edhe ne kemi në librat tona të shenjta budiste, citate që përshkruajnë në mënyrë të përpiktë etapat embriologjike."*

Ne i thamë se dëshironim t'i njihnim ato përshkrime dhe të dinim se çfarë është shkruar në ato libra rreth embrionit.

Profesori na premtoi se pas një viti do të na i sjellë ato. Kur erdhi pas një viti për të testuar studentët e mjekësisë, në univerzitetin e mbretit Abdul Aziz, ia kërkuam citatet që na kish premtuar, por profesori kërkoi falje duke thënë se unë u premtova duke mos e verifikuar këtë gjë, por pas kërkimeve dhe hulumtimeve që bëra, pashë se në librat budiste nuk kishte citate, të cilat flasin për etapat embriologjike.

Pas kësaj ne i ofruam prof. ligjëratën e shkruar nga doktor Keith Moore, me titull: "Përputhshmëria mes embriologjisë dhe asaj që është thënë në Kur'an dhe Sunne".

Kur e pyetëm se a e njihni prof. Kith Mur, na u përgjigj se prof. Moore është ndër dijetarët më të mëdhenj botërorë në këtë fushë. Pasi e lexoi ligjëratën e tij u befasua.

Ne i bëmë prof. Taxhasonit disa pyetje në fushën e anatomisë, ca prej të cilave kishin të bënin me djegiet e Iëkurës. Ai tha: *"Nëse djegia e Iëkurës është e thellë shkakton humbjen e çdo lloj ndieshmërie."*

I thamë se me siguri ju intereson të dini, se në librin e shenjtë, në Kur'anin famëllartë, para më shumë se 1400 vitesh, është aluduar mbi këtë, ku thuhet se pabesimtarët, në Ditën e Ringjalljes, do të dënohen me dënim në ferr dhe sa herë që t'u digjen Iëkurët, Allahu do t'ua ripërtërijë atyre Iëkurën që ta ndiejnë ndëshkimin. Këtu pra, aludohet në atë se qendra e ndjeshmërisë së diegieve ndodhet në Iëkurë. Teksti kur'anor në lidhje me këtë thotë:

“Vërtet ata që mohuan argumente Tona, do t'i hedhim ne zjarr. Sa herë që atyre t'u digjen Iëkurët, ne ua ndërojmë me Iëkurë te tjera që ta shijojnë dënimin. Allahu Fshfi! i Plotfuqishëm dhe i Mënçur.” (En Nisa, 56)

A pajtoheni se kjo që është thënë para 1400 vitesh në Kur'anin e shenjtë ka të bëjë me indet natyrore që gjenden në Iëkurë dhe me ndjeshmërinë e saj?

Prof. Taxhason tha:

"Po! Pajtohem se kjo ka të bëjë me qendrën e ndjeshmërisë së diegieve, sepse në vargun kur'anor thuhet se, kur dikush bën mëkat, do të dënohet në botën tjetër dhe, pasi të digjet Iëkura, Allahu do t'i krijojë atij Iëkurë të re, që të ndiejë përsëri dhimbje dhe kjo gjë do të përsëritet vazhdimisht. Kjo do të thotë, se që para 1400 vitesh në Kur'anin e shenjtë aludohet në atë se qendra e ndjeshmërisë gjendet në Iëkurë."

Është e vërtetë se lëkura është qendra e ndjeshmërisë së diegieve. Nëse ajo digjet plotësisht, ndjeshmëria humbet. Prandaj Allahu i madhëruar në Ditën e Gjykimit do t'i dënojë pabesimtarët me ripërtëritjen e lëkurës, sa herë që të digjet ajo.

Allahu i madhëruar, në Kur'anin famëlartë, thotë:

"Vërtet ata që mohuan argumentet Tona, do t'i hedhim në zjarr Sa herë që atyre t'u digjen lëkurët, Ne ua ndërrojmë me lëkurën të tjera që ta shijojnë dënimin. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Mënçur. " (En Nisa, 56)

Kështu ne prof. Taxhasonit i përmendëm disa vargje kur'anore dhe thënie të pejgamberit, Muhammedit ﷺ dhe e pyetëm atë:

A është e mundur që, Muhammedi ﷺ këto njohuri t'i ketë marrd nga ndonjë burim njerëzor?

Profesori u përgjigj se s'është e mundur një gjë e tillë! E pyetëm: Atëherë nga i mori këto dije? Ai vazhdoi dhe tha: Ju pyes unë juve se nga i mori Muhammedi këto njohuri?!

Ne i thamë: Nga Allahu i madhëruar. Ai tha: Kush është Allahu? Ne i thamë: Allahu është Krijuesi i gjithësisë. Urtësia tregon të urtin, dija në këtë univers tregon se është dhënë nga i Gjithëdituri, përkryeshmëria e universit tregon se është vepër e Gjithënjohësit. Mëshira dëshmon se është dhënë nga Mëshiruesi. Rregulli unik dhe sistemi i përkryer i universit dëshmon, se është vepër e një Krijuesi të Vetëm, të Lartësuar dhe Madhështor."

Prof. Taxhasun u pajtua me tërë këto që thamë. Më pas ai u kthye në vendin e tij, ku mbajti shumë ligjërata mbi këtë fenomen, të cilin e njohu dhe e studioi. Më pas më njoftoi se disa studentë e kanë pranuar fenë Islame, pas ligjëratave që mbajti ai. Pastaj erdhi koha e simpoziumit të 8-të të mjekësisë, në Arabinë Saudite. Në sallën e madhe e cila ishte caktuar për

mbajtjen e simpoziumit shkencor, me titull: "Fenomeni shkencor në Kur'an dhe në Sunne", ai gjatë kater ditëve dëgjoi një numër profesorësh muslimanë, dhe jomuslimanë, të cilët ligjëruan mbi fenomenin shkencor në Kur'an dhe në Sunne. Në fund të këtyre ligjëratave, u ngrit prof. Taxhata Taxhasun, duke thënë:

"Gjatë e 3 viteve të fundit u thellova në studimin e përkthimin e Kur'anit të shenjtë, të cilin ma dhuroi prof. Abdul Mexhid Ez-Zendani. Vitin e kaluar prof. Muvaz më dha ligjëratën e prof. Ez-Zendani dhe prof. Keith Moore, duke kërkuar nga unë që t'i përkthej ato në gjuhën tajlandeze dhe t'u mbaj disa ligjërata muslimanëve në Tajlandë.

Unë iu përgjigja kërkesës së tij. Këtë mund ta shihni në kasetën që ia dhashë atij, e cila përmban studimet e mia dhe atë që kam kuptuar nga konteksti i thënieve. Unë besoj vërtetë se çdo gjë që është përmendur në Kur'an para 1400 vjetësh është e vërtetë e sqëndrueshme dhe mund të shpjegohet përmes shkencës.

Pejgamberi Muhammed s'dinte të shkruante dhe të lexonte. S'ka dyshim se ai është i dërguari i Zotit, i cili na solli të vërtetën. Kjo e vërtetë atij iu dha përmes shpalljes nga Krijuesi, Gjithënjohësi i çdo gjëje. Ky Krijues s'ka dyshim se është Allahu.

Prandaj besoj se erdhi koha që të deklaroj se:

"S'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij".

Së fundi iu falënderoi për përgatitjen e mrekullueshme të këtij simpoziumi, i cili qe në një shkallë të lartë dhe të sukseshme. Pjesët të cilat janë përgatitur për video, padyshim janë arritur me mund. Jam interesuar mjaft jo vetëm në aspektin shkencor, por kam kontaktuar edhe me shkencëtarë duke shfrytëzuar këtë rast të shkëlqyeshëm, që të lidh miqësi me ta.

Padyshim dhurata më e shtrenjtë dhe më e vlefshme që fitova me përqaftimin e fesë islame është besimi se:

"S'ka Zot tjetër përveç Allahut, Muhammedi është i dërguari i Tij. Kështu u bëra mysliman. Allahu është Thënës i së vërtetës.

"Në emër të Allahut, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit".

"E atyre që u është dhënë dija, e din se kjo që të është shpallur nga Zoti yt, është e vërtetë dhe udhëzon ne rrugën e të Gjithëfuqishmit dhe ti! Lavdëruarit." (Sebe,6)

PJESA E KATËRT RRETH THËNJEVE TE PROF. KRONER NË LIDHJE ME TE DHËNAT KUR'ANORE RRETH, GJELOGJISË DHE FORMIMIT TE TRUPAVE

PROF. ALFRED KRONER

"Shumë të vërteta të përmendura në Kur'an nuk qe e mundur që të vertetoheshin në atë kohë, mirëpo sot përmes shkencës bashkëkohore u bë e mundur të vertetohet ajo që u tha në Kur'an dhe në Sunne, para 1400 vitesh."

PROF. ABDUL MEXHID EZ ZENDANI

Ky është prof. Alfred Kroner, njëri ndër shkencëtarët më të njohur botërorë të gjeologjisë. U bë i njohur në mesin e shkencëtarëve me kritikën që u bëri teorive të dijetarëve më të mëdhenj botërorë, në Iëmin e gjeologjisë. U takuam me të dhe i ofruam disa citate kur'anore dhe thënie të pejgamberit, Muhammedit ﷺ. Më pas diskutuam rreth tyre.

Në fund prof Kroner tha:

"Duke menduar më thellë rreth këtyre çështjeve dhe rreth asaj se nga i mori Muhammedi ato njohuri, kur dihet se ai ishte beduin dhe analfabet, besoj se është e pamundur që vetë ai, të mund të sillte njohuri kaq të sakta mbi gjithësinë dhe krijimin e saj. Këto njohuri shkencëtarët i zbuluan vetëm para disa vitesh me anën e mjeteve të sofistikuara bashkëkohore."

Për të provuar faktin se Kur'ani nuk është rezultat i një njeriu analfabet, siç ishte Muhammedi ﷺ, prof. Kroner mori shembullin kur'anor, i cili flet mbi atë se gjithësia në fillim ishte një tërësi.

Në Kur'anin e shenjtë thuhet:

"A nuk e dine mosbesimtarët se qiej dhe toka ishin një tërësi e Ne i ndamë ato dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi..."

Fjala e përmendur në Kur'an "RET'KAN", sipas komentatorëve të shquar të Kur'anit, Ibn Abasit, Muxhahidit dhe të tjerë (Allahu qoftë i kënaqur me ta), do të thotë se qiejt dhe toka ishin të ngjitura, e pastaj u ndanë.

Prof. Kroner mori si shëmbull këtë citat kur'anor, për të vertetuar se kjo e vërtetë e përmendur në Kur'an s'mund të ishte rezultat i mendjes së Muhammedit ﷺ dhe as i njohurive njerëzore të asaj kohe.

Prof. Kroner gjithashtu, shprehet:

"Një njeri që nuk dinte asgjë mbi fizikën nukleare, sipas mendimit tim, është e pamundur që para 1400 vitesh me mendjen e vet të zbulonte se toka dhe qiejt ishin një tërësi apo dhe shumë çështje të tjera rreth të cilave biseduam së bashku."

Sa herë që i jepej rasti, prof Kroner mundohej t'i shmangej përgjigjes. Më kujtohet një rast, kur ne biseduam së bashku rreth vendeve arabe dhe e pyetëm atë: "A nuk ishin vendet arabe të gjelbëruara dhe të pasura me kopshte dhe lumenj?"

"Po" - u përgjigj ai.

I thamë: "E kur ka ndodhur kjo?"

Ai tha: "Në kohën e akullnajave, akujt e grumbulluar në Polin e Ngrirë të Veriut filluan të rrëshqasin drejt Jugut dhe, kur ato i ishin afruar relativisht gadishullit arabik, ndryshoi temperatura, gjë që bëri që ky gadishull të ishte një ndër vendet më të pasura me kopshte, lumenj dhe të reshura."

E pyetëm profesorin : "A do të jetë përsëri gadishulli arabik me kopshte dhe lumenj?" "Po" - tha ai. Kjo është e vërtetë shkencore"

U befasuam me fjalët e tij dhe i thamë:

"Ju thoni se kjo është e vërtetë shkencore, kur kjo çështje ka të bëjë me të ardhmen?" PROF. KRONER tha:

"Koha e re e akullnajave ka filluar. Akulli për herë të dytë ka filluar të rrëshqasë nga Poli i Veriut në drejtim të Jugut. Tani ai ka marrë rrugën e tij në drejtim të gadishullit arabik. Dëshmi për këtë është ajo që dëgjojmë mbi fortunat e forta, të cilat përfshijnë vendet veriore në Evropë dhe Amerikë. Kjo është dëshmi mbi atë që thamë. Shkencëtarët kanë edhe fakte të tjera rreth kësaj çështjeje dhe kjo është e vërtetë shkencore."

Pastaj i thamë profesorit: "Këtë që thatë ju, shkencëtarët arritën ta zbulojnë pas një kohe të gjatë hulumtimesh dhe me mjete të sofistikuara, të cilat lehtësuan dhe mundësuan këtë zbulim.

Ndërkaq kjo e vërtetë është përmendur, nga i dërguari i Allahut, Muhammedi ﷺ para më shumë se 1400 vjetësh. Në hadithin e transmetuar nga Muslimi, Muhammedi ﷺ thotë:

"Nuk do të shkaterrohet bota, derisa vendet arabe të mos mbushen me kopshte e lumenj. "

E pyetëm profesorin: "Kush e informoi Muhammedin ﷺ se vendet arabe kishin qenë të pasura me kopshte dhe lumenj?"

"Romakët" - u përgjigj ai.

M'u kujtua se ai gjithmonë donte të gjente rrugëdalje. Vendosi më t'i bëjmë një pyetje tjetër: "E kush e njoftoi atë, se këto vende përsëri do të mbushen me kopshte e lumenj?"

Gjithnjë mendohej të gjente rrugëdalje, por kur e kuptonte të vërtetën tregohej i guximshëm dhe e shprehte mendimin hapur.

Më në fund prof. Kroner pohoi:

"Kjo patjetër duhet të jetë shpallur nga Zoti." Pas diskutimit të gjatë që bëme me të, ai deklaroi:

"Besoj se të gjitha çështjet që janë përmendur në Kur'an, të cilat kanë të bëjnë me tokën dhe krijimin, si dhe me shkencën në përgjithësi janë të vërteta, të padiskutueshme. Këto mund të vërtetohen shkencërisht. Prandaj mund të themi se Kur'ani është libër që përmban të vërteta shkencore konçize. Vertetimi i shumë fakteve të paraqitura në Kur'an në atë kohë ishte i pamundur. Sot shkenca bashkëkohore është në gjendje të vërtetojë atë që tha Muhammedi ﷺ para 1400 vjetësh".

Allahu është Thënës i së vërtetës. Në librin e Tij, në Kur'anin e shenjtë Ai thotë:

Kur'ani është këshillë për të gjitha botërat. Ju gjithsesi do ta kuptoni këtë, madje qoftë edhe me vonë" (Sad, 87, 88)

"Në emër të Allahut, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit".

"E atyre që u është dhënë dija e dine se kjo që të është shpallur nga Zoti yt, është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e të Gjithëfuqishmit dhe të Lavdëruarit." (Sebe, 6)

PJESA E PESTË PËRSHKTIIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM I ETAPAVE TE KRIJIMIT TE NJERIUT NË KUR'AN

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botërave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Ky është profesor MARSHALL XHONSON. përgjegjës i Katedrës së anatomisë dhe drejtor i institutit "DANIEL", në universitetin "TOMAS XHEFERSON" në Filadelfia të SHBA-së. Me të u takuam në simpoziumin e shtatë të mjekësisë në Arabinë Saudite.

Ishte caktuar një komision që do të studionte IXHAZIN-MREKULLINË shkencore në Kur'an dhe Sunnet.

Sapo u takuam në këtë komision ai na pyeti se cila është tema e komisionit tonë?

Ju përgjigjëm duke i thënë se tema e komisionit tonë është të shqyrtuarit e lidhshmërisë në mes asaj që është përmendur në Kur'an dhe Sunne, para 1400 vjetësh dhe asaj që është zbuluar nga shkenca bashkëkohore. Ai pyeti se çfarë konkretisht?

Ju përgjigjëm duke i thënë se shkenca ka zbuluar se krijimi i njeriut kalon në disa perioda dhe këto perioda janë përmendur në Kur'an para më shumë se 1400 vjetësh.

Ishte ulur dhe u ngrit në këmbë duke thënë: JO, JO, s'ka mundësi! I thamë: Ulu doktor! Ai thotë: NUK ULEM!... Ç'janë këto fjalë që thoni?!

Kuptuam se çfarë tronditje shkaktuan këto fjalë tek profesori!

Ai është ndër dijetarët më të shquar në Amerikë. Ai e di se njerëzimi e zbuloi mikroskopin në shek. e 16-të. Mjekët edhe në shek. e 17-të besonin se njeriu formohet si krijesë e plotë në spermën e cila del nga mashkulli, siç shihet në këtë figurë.




fig. 7

Këtë vizatim e bënë mjekët e asaj kohe për të dëshmuar se njeriu krijohet nga sperma e mashkullit. Kjo bindje vazhdoi deri në shek. e 18-të.

Kur e zbuluan vezën femërore, në shek. e 18-të ata e ndërruan mendimin duke thënë se njeriu formohet si një krijesë e plotë në vezën e femrës, sepse ajo është më e madhe!

Kështu ata e injoruan rolin e mashkullit, siç e injoruan më pranë, në shek. e 17-të rolin e femrës.

Në gjysmën e shek. të 19-të dijetarët filluan të zbulojnë se krijimi i embrionit të njeriut kalon në disa etapa.

Prandaj profesor Marshall Xhonsonit kur iu tha se kjo gjë është përmendur në Kur'an para më shumë se 1400 vjetësh, ai u ngrit në këmbë duke e mohuar një gjë të tillë me zë të lartë.

U ngritëm dhe i ofruam Kur'anin, duke i thënë: Urdhëro, lexo!

Ne ia lexuam vargun Kur'anor në gjuhën arabe dhe ai e lexoi përkthimin e tij, në gjuhën angleze. Ia lexuam fjalët e Allahut të madhëruar në Kur'an, ku thuhet:

"Dhe Ai është që krijoi llojet: mashkullin dhe femrën, nga pika e farës që hidhet " (en-Nexhm.45,46)

"Ç'është me ju që Allahut nuk ia shprehni madhërinë që e meriton?! Ai ju krijoi në disa etapa!" , (Nuk 13-14)

"Ai ju krijoi juve në mitrën e nënave tuaja, etapë pas etape, në tre errësira! Ky Fshehte Allahu, Zoti juaj! (ez-Zumer 6)

Ai u ul dhe tha: Kjo mund të ketë 3 shpjegime:

I pari: Mund të jetë rastësisht! U habitëm me të!

Atij i ofruam mbi 25 vargje kur'anore, të cilat flasin mbi këtë temë. I thamë:

A mundet, vallë që të gjitha këto vargje të jenë të rastësishme?! Pastaj Kur'ani i ka emërtuar këto faza si: "NUTFE", që do të thotë "pikë uji"; "ALAKAH" që do të thotë diçka që ngjit; "MUDGAH", që do të thotë mish i përtypur, pastaj ka përmendur formimin e eshtrave, veshjen e eshtrave me mish dhe krijimin tjetër. Pra, këto faza Kur'ani i ka emërtuar! A është e mundur që kjo të jetë rastësisht?! Ai tha: JO. Pastaj i thamë: - Po atëherë si mund të jetë?

Mund të thuhet se Muhammedi pati një mikroskop të madh - tha ai!

- Thamë: Ju e dini se këto perioda paraqesin hollësi dhe detaje. Këto gjëra, të cilat i zbuloi shkenca dhe i përmendi Kur'ani, s'mund të arrihen përveçse nëpërmjet një mikroskopi të përsosur, e ai që do të kishte një mikroskop të tillë patjetër që do të kishte arritur një teknikë të lartë. Sikur të ishte kështu. kjo do të manifestohej në jetesën e tij, në të gjitha rrethanat. Patjetër që këto arritje do t'i kish marrë nga brezat paraardhës dhe do t'ua trashëgonte brezavepasardhës.

Pas kësaj ai qeshi dhe tha:

"Në një panair kam parë mikroskopin e parë që u zbulua në botë. Ky mikroskop e zmadhon fotografinë 15 herë, dhe fotografia s'del e qartë".

Jo, Muhammedi ﷺ nuk pati ndonjë aparat ose mikroskop, pra nuk ngelet gjë tjetër, veç të themi se Muhammedi është i dërguari i Allahut.

Pas kësaj ai u muar me këto studime që kishin të bënin me mrekullinë shkencore të Kur'anit. Në disa seminare të tij, ai u përqëndrua në periodat e embrionit. Profesor MUR dhe disa të tjerë diskutuan mbi pamjen e jashtme të embrionit, ndërsa profesor Xhonson u paraqit me seminarin e tij, mbi përshkrimin e saktë që Kur'ani i bën embrionit nga forma e jashtme dhe përbërja e brendëshme e tij.

PROF XHONSON tha:

"Në realitet Kur'ani i përshkruan periodat e jashtme të embrionit, por ai gjithashtu i përshkruan edhe periodat e brendëshme të tij gjatë krijimit dhe zhvillimit, duke i vërtetuar ndryshimet kryesore që pëson ai, gjë të cilën e kanë zbuluar dijetarët e sotëm. Faleminderit!"

Këtë figurë që e shohim, na tregon periodën të cilën Kur'ani e përshkruan me fjalën "MUDGAH", që do të thotë "mish i

përtypur". Ai e përdori këtë si argument në mesin e argumenteve të tjera që ai solli (fig. 8).




Figura e këtij mishi të përtypur gjegjësisht "MUDGAH" na paraqet pamjen e jashtme të embrionit. Siç e shohim ai është në formë harku dhe në fund të këtij harku ka gjurmë, të cilat u përngjajnë gjurmëve të dhëmbëve, duke na dhënë kështu pamjen e mishit të përtypur.

Ne shohim ënjtje, plasaritje në formë të lakuar që na jep pamjen e mishit të përtypur siç e përshkruan Kur'ani me fjalën "MUDGAH".

Kjo copë mishi ka gjatësi prej 1 cm.

Nëse atë e ndajmë në dysh dhe duam t'i shpjegojmë pjesët e brendshme të saj, do të shohim se pjesët më të mëdha kanë filluar të formohen siç është e qartë në figurën 8.

- Në figurën 8, shohim se një pjesë e gjymtyrëve kanë filluar të formohen, kurse pjesa tjetër akoma s'ka filluar të formohet, dhe nëse dëshirojmë që ta përshkruajmë këtë copë mishi, sikurse thotë profesor Marshall Xhonson, atëherë si të themi?

Të themi se ajo është e formuar... kjo do të nënkuptojë pjesën e cila është e formuar, nëse themi se është e paformuar do të nënkuptojë pjesën e cila s'është e formuar. Prandaj patjetër, kur ta përshkruajmë këtë copë mishi në përbërjen e saj të brendshme - thotë *PROFESOR XHONSON*, duhet ta përshkruajmë ashtu siç e ka përshkruar Kur'ani, ku thuhet:

„...pastaj (iu krijojmë) prej një copë mishi që është e formuar ose e paformuar" (el-Haxh, 5)

"Unë si dijetar - thotë *PROFESOR XHONSON* mund të merrem vetëm me gjera që mund t'i shoh saktësisht, mund të kuptoj embriologjinë, zhvillimin e biologjisë, mund të kuptoj fjalët, të cilat më përkthehen nga Kur'ani...

Siç ua solla më parë shembullin, sikur unë të imagjinoj që të jetoj në atë kohë me këto dije që kam mësuar deri më sot, s'do t'i përshkruaja gjërat ashtu siç janë përshkruar në Kur'an. Unë nuk e shoh se ka ndonjë shkas apo fakt i cili tregon, se Muhammedi ﷺ zotëronte ndonjë mjet, i cili ia mundësoi marrjen e këtyre njohurive nga ndonjë vend. Për këtë arsye nuk shoh asgjë, që e bën të pamundur të kuptuarit se kjo ishte frymëzim ose **SHPALLJE HYJNORE**, të cilën ai arriti ta transmetojë."

Ky është profesor *MARSHALL XHONSON*, i cili në fillim nuk pranoi të dhënat shkencore në Kur'an, kurse më vonë mbajti seminare në një numër simpoziumesh për to. Kur u kërkua që të japë mendimin e tij rreth asaj që ka zbuluar shkenca me të cilën vërtetohet ajo që ka thënë Kur'ani famëlartë dhe Sunnet, ai tha:

"Po, Kur'ani është **SHPALLJE** nga Zoti".

S'ka rrugëdalje tjetër për njerëzimin veçse të pranojë atë që pranuan këta dijetarë. Vërtet Allahu i madhëruar i shpalli Muhammedit ﷺ Kur'anin me dijen e Tij dhe i premtoi njerëzimit se gjatë zhvillimit të tyre do të zbulojnë atë që do të vërtetojë se

Kur'ani është libër i Zotit, ashtu siç thotë Allahu i madhëruar:

"E ju gjithsesi, me vonë do ta kuptoni vërtetësinë e Kur'anit. " (Sad,88).

Gjithashtu Allahu i madhëruar thotë:

"Çdo lajm e ka afatin e realizimit e me vonë ju do ta kuptoni." Dhe në një varg tjetër Kur'anor, Allahu thotë: (el-Enam, 67)

"Ne do t'ua bëjmë atyre tili mundëshme që ti shohin shenjat Tona ne horizonte dhe ne veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se Kurani është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë". (Fussilet,53)

"Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit. "

"E atyre që u është dhënë dija, e dinë se kjo që të është shpallur nga Zoti yt, është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e të Gjithëfuqishmit dhe të Lavdëruarit." (Sebe, 6)

PJESA E GJASHTË RRETH PËRPUTHSHMËRISË SE DISA ZBULIMEVE NË EKZISTENCË ME TE DHËNAT KUR'ANORE

PROF JUSHJUDI KOZAN.

"Jam shumë i impresionuar me të zbuluarit e se vërtetës në Kur'anin famëlartë"

PROF. EZ-ZENDANI

Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju!

Ky profesor flet në gjuhën e tij japoneze. Është profesor JUSHJUDI KOZAN, drejtor i institutit astronomik në Tokio.

Në fillim i treguam disa vargje kur'anore të cilat flasin për fillimin e krijimit dhe për atë që toka dhe qielli ishin një. Prof Jushujdi kur e lexoi domethënien e këtyre vargjeve kur'anore, filloi të na pyesë mbi Kur'anin dhe kohën kur ka zbritur ai. I treguam se Kur'ani ka zbritur para më shumë se 1400 vjetësh. Ne e pyetëm rreth këtyre të vërtetave, me të cilat kishin të bënin vargjet kur'anore. Ai na u përgjegj dhe pas çdo përgjigjeje ne i lexonim nga një varg kur'anor. I magjepsur dhe i habitur, ai tha:

"Vërtet Kur'ani e përshkruan universin nga pika më e lartë e ekzistencës. Çdo gjë para tij është e hapur. Ai prej të cilit ka ardhur Kur'ani e sheh çdo gjë në univers. Asgjë s'është e fshehur për Të."

- E pyetëm për periudhën kohore, kur qielli ishte një masë fillestare gazore. Na u përgjegj se faktet që vertetojnë këtë, janë të shumta. Tani thotë prof. Kozan, kjo gjë është bërë e dukshme

dhe e qartë. Sot ne shohim yje në qiell të cilat përbëhen nga kjo masë gazore, masë e cila është bazë e universit, siç shihet në këtë fotografi.



fig. 9

Kjo fotografi u bë kohët e fundit nëpërmjet anijeve kozmike. Në këtë fotografi është fotografuar një prej galaktikave dhe shihet qartë se ajo është e përbërë nga tymi.

Shikoni anët e kuqe të galaktikës, e cila gjendet në fillim të flakërimit, kurse në mes ku flaka është e fortë, shihet ndriçim. Kështu pra këto yje të shndritshme në fillim ishin tym ose masë gazore.

I gjithë universi ishte tym ose masë gazore. Profesorit i lexuam vargun kur'anor ku thuhet:

"Pastaj Zoti iu drejtua qiellit i cili ishte tym dhe atij dhe tokës i tha: NENSHTROJUNI urdhrin 'Tim me dëshirë ose me dhunë! Ata të dy thanë po i nënshtrohemi me dëshirë" (Fussilet,11)

Disa dijetarë duke folur mbi fazën fillestare të qiellit, thonë se ai ishte **"MJEGULLNAJË"**.

Profesor Jushjudi Kozan, thotë se fjala "mjegullnajë" nuk i përshtatet përshkrimit të bërë me fjalën "TYM" në Kur'an, sepse mjegullnaja është e ftohtë, kurse ky tym përmban një sasi xehhtësie. Prandaj përshkrimi më i mirë është me fjalën "TYM". Pra, kjo që thotë profesor Kozan përputhet plotësisht me ajetin kur'anor.

Kështu ai filloi të shpjegojë vargjet që ia lexonim. Në fund e pyetëm:

Ç'farë mendoni mbi këtë fenomen profesor, për të cilin ju jeni dëshmitar? Shkenca me përparimin e saj po zbulon sekretet e universit. Shumë nga këto sekrete janë përmendur në Kur'an, ose në thëniet e Muhammedit ﷺ A mendoni se ky Kur'an të cilin na solli Muhammedi ﷺ mund të jetë produkt i mendjes njerëzore? PROE KOZAN në ligjëratën e tij tha:

"Jam i impresionuar shumë me zbulimin e së vërtetës në Kur'an, para nesh astronomët u morën me studimin e pjesëve të kufizuara në qiell, kurse ne jemi përqëndruar në të kuptuarit e këtyre pjesëve, sepse nëpërmjet teleskopit ne mund t'i shohim të gjithë pjesët kryesore në qiell e gjithashtu nëpërmjet të lexuarit të Kur'anit marrim edhe përgjigjen e pyetjeve. Besoj se unë mund ta gjej rrugën time të ardhshme për studimin e universit."

PROF. EZ. ZENDAN

Pra, siç e shohim ai thotë se s'është e mundur që. Kur'ani të jetë produkt i mendjes njerëzore. Gjithashtu ai thotë: Ne dijetarët në studimet tona jemi përqëndruar në një pjesë të vogël, ndërsa kush e lexon Kur'anin ka para vetes tablo të një përshkrimi të gjërë mbi universin.

PROF. KOZAN, gjithashtu tha:

Unë njoha një metodë të re në studimin e universit.

Atë duhet ta vështrojmë në mënyrë të gjithanshme dhe jo në mënyrë të pjesërishme. Unë do t'i përmbahem kësaj metode dhe, pasi lexova Kur'anin e u njoha me këto vargje kur'anore, të cilat flasin mbi universin, zbulova metodën e të studiuarit tim në të ardhmen. Në seminarët e mia të ardhshme do të kem një vështrim të gjithanshëm, gjë të cilën e fitova nga libri i Allahut.

PROF. EZ ZENDANI

I lartësuar je o Zot, i lartësuar je Ti, o Allah!

Ja, dijetarët e Lindjes dhe të Perëndimit po i përulin kokat e tyre në shenjë respekti ndaj Kur'anit famëlartë.

Kur'ani është argument i Muhammedit ﷺ Është mrekulli e përhershme dhe e vazhdueshme, është mrekulli e gjallë, i cili i bind muslimanët dhe jomuslimanët e kështu do t'i bindë brezat e ardhshëm deri në Ditën e Gjyqit.

"Po Allahu dëshmon për ate që t'u zbrit ty, atë ta zbriti sipas dijes së Vet" (en Nisa, 166)

"Dhe thuaj: Falenderuar qoftë Allahu, e Ai do tua tregojë argumentet e Veta dhe do ti njihni ato..." (en Neml, 93)

"Në emër të Allahut, Bamiresit të përgjithshëm, Mëshiruesit! "

"E atyre që u është dhënë dija, e dine se kjo që te është shpallur nga Zoti yt, është e vërtetë dhe udhëzon ne rrugën e Gjithëfuqishmit dhe te Lavdëruarit." (Sebe, 6)

PJESA E SHTATË ISLAMI DHE SHKENCA

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Mendimi perëndimor zhvilloi një betejë të fortë dhe të rreptë mes fesë dhe shkencës. Dijetari perëndimor s'mund të pranojë se ekziston përputhshmëri midis fesë dhe shkencës. Dhjata e Vjetër thotë se pema që iu ndalua Ademit ﷺ në Parajsë, Xhenet, ishte pema e "njohjes" dhe Ademi ﷺ, pasi hëngri frytet e saj, sipas Dhjatës së Vjetër fitoi "aftësinë e njohjes".

Për këtë arsye evropianët më shumë se dy shekuj diskutuan rreth pranimit ose mospranimit të arritjeve shkencore të cilat vinin nga vendet muslimane. Këto lloj dijesh konsideroheshin nga priftërinjtë mëkat shumë i madh. Dëshmi për këtë sipas tyre ishte pema "e njohjes", me ngrënien e frutave të së cilës, Ademi ﷺ fitoi "aftësinë e njohjes" gjë që sipas tyre ai fitoi zemërimin e Allahut dhe u dëbua nga Parajsa.

Për këtë arsye dijetarët perëndimorë refuzuan dijet shkencore të botës myslimane, madje i luftuan ato, duke i konsideruar mëkat. Por, më vonë, në perëndim, kur dijetarët fituan betejën ndaj kishës dhe inkuizicionit të saj, për t'u hakmarrë ndaj saj ata hodhën poshtë çdo gjë që kishte të bënte me fenë...

Prandaj, kur njeriu flet me një dijetar perëndimor mbi lidhjet që ekzistojnë mes fesë dhe shkencës, ai i befasuar thotë: Ç'thua ?! S'ka mundësi!!

Dijetarët perëndimorë nuk e njohin fenë islame. Ata nuk e dinë se Islami lartësoi dijen dhe dijetarët. Islami dijetarët i bëri dëshmitarë menjëherë pas engujve, të cilët dëshmojnë se s'ka Zot tjetër veç Allahut (i cili është Një, s'ka lindur dhe s'është i

lindur. Askush dhe asgjë s'është i barabartë me Allahun). Allahu i Lartëmadhëruar në Kur'anin famëlartë, thotë:

"Allahu dëshmoi se nuk ka Zot tjetër përveç Tij, këtë e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët." (Ali Imran, 18)

"Dije se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut." (Muhammed, 19)

Pra, dijetarët e Perëndimit nuk e dinë se ajo që e ngriti Ademin ﷺ mbi engjujt ishte dija¹. Rrëfimi kur'anor na mëson të vërtetën e cila ishte shtrembëruar më parë. Për hir të dijes Ademi ﷺ u lartësua mbi gjithë krijesat e tjera. Nga kjo kuptohet rëndësia që i jepet shkencës në fenë Islame.

Kur ne flasim me një dijetar perëndimor mbi fenë islame dhe shkencën, ai mendon se ekziston i njëjti raport siç është në mes fesë së tyre dhe shkencës.

Më pas, ata mbesin të mahnitur, kur hasin në fenë islame të vërtetat e qarta dhe të pakundërshtueshme shkencore. Një ndër ata dijetarë është edhe XHULI SAMSUN, profesor i gjinekologjisë në universitetin NORTH WESTERN, në Çikago të SHBA.

Kur u takuam në fillim, ai dyshonte nëse këto citate ishin në Kur'an dhe në thënie të Muhammedit ﷺ Pasi e vërtetoi një gjë të tillë dhe u ndesh me citatet kur'anore, që flasin mbi gjenet dhe ndryshimet që pëson embrioni në periodat e para, kur ai është

¹ Kur Ademi ﷺ i tha emërtimeve të sendeve ta cilat Allahu ia kishte mësuar më parë, emërtime ta cilat engjëjt nuk i dinin, atëherë Allahu i urdhëroi engjëjt që ta përulëshin para Ademit, si shenjë respekti për dijen që ai kishte. Pra, ngrënia e fruteve ta pemës sa ndaluar nuk ishte shkaku i vërtetë or dëbimin e Ademit ﷺ nga Parajsa, sepse qysh më parë Allahu e kish paracaktuar atë që ta ishte mëkëmbës i Tij në tokë. Madje, Ademi ﷺ zotëronte aftësinë e njohjes qysh para se të vendosej në Parajsë, dhe ta hante nga frutet e pemës sa ndaluar. Për hir ta aftësisë sa njohjes që zotëronte Ademi ﷺ, engjëjt para se Ademi ﷺ ta hynte në Xhenet iu përulën atij në shenjë respekti.

pikë uji etj. Pastaj pa përshkrimin preciz që i bën Kur'ani krijimit të njeriut, si dhe vetitë që trashëgohen nga këto kromozome.

Në këto kromozome gjenden cilësitë e njeriut që do të lindë; ngjyra e syve, e lëkurës, e flokëve dhe shumë cilësi tjera.


Pra, njeriu që në këto kromozome është i përcaktuar.

Këto kromozome janë në fazën, kur embrioni është një pikë uji. Kjo do të thotë se njeriu është i përcaktuar që kur embrioni është një pikë uji.

Allahu i Lartëmadhëruar në Kur'an thotë:

"...sa mohues i forte është ai (njeriu)! Prej çka e krijoi Allahu atë? Ate e krijoi prej një pike uji dhe e përcaktoi" (Abese 17,18)

Në embrion gjatë 40 ditëve të para formohen të gjitha organet dhe të gjitha pjesët janë të ngjitura njëra me tjetrën. (fig. 10).



Pra, organet fillojnë të krijohen dhe embrioni ka formën e harkut.

I dërguari i Allahut, Muhammedi ﷺ thotë:

"Vërtet çdonjëri nga ju formohet në mitrën e nënës së tij në dyzet ditët e para..."

Profesor Xhuli Samsun e mori këtë hadith dhe hadithin tjetër, ku Muhammedi ﷺ thotë: "Kur embrioni i kalon 42 ditë Allahu e dërgon engjëllin për t'i dhënë formën atij ". Ai bëri krahasimin mes këtyre dy thënieve të Muhammedit ﷺ dhe konstatoi se ajo që i ndante këto dy hadithe ishte numri 40.

Prof. Samsuni pasi i pa këto të dhëna të detajuara dhe preçize, në një simpozium, shprehu mendimin e tij rreth kësaj çështjeje, duke thënë:

"Nga këto dy thënie të Muhammedit ﷺ mund të nxirren në mënyrë preçize ndryshimet që i pëson embrioni në 40 ditët e para. Një gjë e tillë u vertetua edhe nga biseduesit e ditës së sotme. Këto të vërteta shkencore që përmbajnë hadithet nuk njiheshin në atë kohë, prandaj ato s'janë te bazuara në dijet a asaj kohe.

Këto thënie të Muhammedit ﷺ janë reflektim i njohjes (shpalljes) hyjnore". PROF EZ ZENDANI

Ai gjithashtu thotë: Feja mund t'i paraprijë shkencës në mënyrë të suksesshme! Mos të harrojmë se disa fe mbajnë qëndrim negativ ndaj shkencës.

Por ky profesor thotë se feja mund t'i paraprijë shkencës me sukses dhe ai ka parasysh fend islame.

S'ka dyshim se po...

Nëse hyjmë në një fabrikë dhe në dorë kemi katalogun, me lehtësi do të kuptojmë atë që është në të. Ndërsa ai që hyn në fabrikë dhe s'ka asgjë në dorë, s'do ta ketë të lehtë të kuptojë atë që është në të.

Profesor Xhuli Samsun u drejtohet dijetarëve me këto fjalë:

"Unë besoj se s'ka kundërshtim mes njohurive shkencore dhe shpalljes islame. Islami i përkrah dhe i nxit metodat shkencore.

Shfaqja kur'anore e cila iu zbulua Muhammedit ﷺ, para 1400 vjetësh aludon në të vërtetat shkencore rreth të cilave u diskutua në simpozium. Kjo dëshmon se:

"KUR'ANI ËSHTË FJALË E ALLAHUT." PROF EZ
ZENDANI

Po... Muslimanët përsëri mund të jenë pishtarët e dijes, sikurse ishin më parë, duke ia dhënë dijes vendin që meriton ajo dhe duke e bërë "dijen" dëshmi për besimin në Allahun, xh.a. Zotin e universit, dhe në vërtetësinë e peygamberisë së Muhammedit ﷺ

Të vërtetën e thotë Allahu i Madhëruar:

"Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që të shohin shenjat Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se Kur'ani është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë!"

(Fussilet, 53)

"Në emët të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit!"

"E atyre që u është dhënë dija, e dinë se kjo që të është shpallur nga Zoti yt, është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e të Gjithëdhishmit dhe të Lavdëruar." (Sebe, 6)

PJESA E TETË

ARGUMENTET QË GJENDEN NE DETE DHE OQEANE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave. Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Ky është profesor Haj. Me të bëmë një udhëtim në det që të na tregonte mbi disa dukuri detare, të cilat kishin të bënin me temën e seminareve tona, rreth mrekullisë shkencore në Kur'an dhe në Sunnet.

Profesor Haj është ndër dijetarët më të njohur të oqeanologjisë në Amerikë. Gjatë këtij udhëtimi e pyetëm mbi shumë dukuri detare si dhe rreth sipërfaqes së deteve dhe asaj që e ndan pjesën sipërfaqësore të deteve dhe thellësirave të tyre. E pyetëm gjithashtu edhe mbi pengesat ujore në mes të ujërave të deteve dhe lumenjve dhe ai na, u përgjigj në mënyrë të hollësishme për të gjitha këto. Kur filluam të merremi me sqarimin e pengesave në mes të deteve të kripur, ai shpjegoi se detet e kripur s'janë një det ashtu siç i sheh syri, por ata janë dete të ndryshëm, kanë shkallë të ndryshme temperature, kripe dhe dendësie siç shihet në këtë fotografi.



Në këtë fotografi shohim vijat e bardha, që simbolizojnë pengesat që gjenden në mes deteve. Ç'do pengesë bën ndarjen në mes dy deteve të ndryshëm, të cilët ndryshojnë nga temperatura, përqindja e kripës dendësia, gjallesat ujore dhe oksigjeni.

Kjo fotografi me këtë pamje për herë të parë është bërë në vitin 1942, pasi dijetarët vendosën qindra pika studimi mbi det për të studiuar veçoritë e tij.

Do të shohim në vijim atë që ndan detin Mesdhe nga oqeani Atlantik. Këtu në mes gjendet trekëndëshi që tregon malin e Tarikut, sipas të cilit ka marrë emrin ngushtica e Gjibraltarit (rrjedh nga fjala Xhebel-kodër dhe Tarik sipas Tarik ibn Zijad-it). Këtu shohim me ngjyra të qarta atë që dallon ujërat e deteve. Kjo gjë nuk duket me sy, mirëpo tani ajo është e vërtetë shkencore. Përsosja e satelitëve ka bërë të mundur studimin e deteve. Kështu me ndihmën e tyre u bë nga lartësi të mëdha fotografimi i deteve. Pra, këta satelitë mundësuan fotografimin e

këtyre deteve si dhe kufijtë që ndajnë detet apo thënd më mirë ajo që ndan detet nga njëri - tjetri. (fig. 11)

Kjo fotografi është bërë nga satelitët. Detet këtu duken me ngjyra të ndryshme siç i shohim. Disa nga ata me ngjyrë të kaltër të çelur, disa me ngjyrë blu të mbyllur, disa me ngjyrë të zezë, disa me ngjyrë të ngjashme me të gjelbrën. Këto ngjyra të ndryshme janë si rezultat i ndryshueshmërisë së temperaturës mbi sipërfaqen e deteve. Ndërkaq nëse qëndrojmë mbi sipërfaqen e detit ne nuk shohim gjë tjetër veqse ujë me ngjyrë të kaltër në të gjitha këto dete e oqeane. Këto dallime janë të padukshme me sy. Këto janë zbuluar nëpërmjet një studimi të thellë dhe me mjete të një teknologjie bashkëkohore.

Rreth këtij fenomeni në Kur'an thuhet:

"Ai i lejoi dy detet që të puqen mes vete. Ndërmjet atyre të dyve UshhU një pengesë që ata nuk e kapërcejnë." (err-Rahman 19, 20)

Pra, siq e shohim kjo pengesë është ajo që i ndan detet. Dijetarët myslimanë rreth komentimit të këtij vargu kur'anor dhanë dy mendime. Grupi i parë tha:

Fjala "*merexhe*" e përdorur në këtë varg kur'anor në kuptimin etimologjik ka kuptimin e "përzierjes", që, sipas tyre do të thotë se Zoti i përzier dy detet, kurse fjala "në mes atyre të dyve është një pengesë" dhe fjalia "ata nuk e kapërcejnë", nënkupton atë që uji i njërin det s'mund të kalojë ujin e detit tjetër.

Grupi i dytë duke iu përgjigjur grupit të parë tha: Meqenëse mes tyre ka pengesa dhe në fund të vargut kur'anor thuhet se ata nuk e kapërcejnë pengesën, atëherë si thonë se fjala "*merexhe*" do të thotë "përzierje".

Ndërkaq zbulimet shkencore treguan domethënien e vërtetë të këtyre vargjeve kur'anore. Pra, ujerat e detit Mesdhe përziehen

me ujrën e oqeanit Atlantik dhe anasjelltas dhe në mes tyre ka pengesë ujore. Kur uji i njërit det e kalon këtë pengesë dhe kalon në detin tjetër fillon të humbë veqoritë e tij, duke marrë vetitë e ujit tjetër. Kjo përputhet plotësisht me përshkrimin kur'anor ku thuhet "se asnjë det nuk e kapërcen detin tjetër". Pra, me kalimin e ujit nga njëri det në tjetrin, uji që kalon pengesën fillon të marrë veqoritë e ujit tjetër. Me zhvillimin e shkencës u bë i mundur kuptimi i drejtë i vargjeve kur'anore duke dëshmuar kështu edhe një herë mbi mrekullinë e Kur'anit.

Me profesor Haj biseduam mbi këtë fenomen të përmendur në këtë varg kur'anor dhe vargje të tjera kur'anore. Në fund e pyetëm:

"Çfarë mendoni mbi këtë fenomen të cilin po e shihni në vargjet kur'anore të cilat zbritën para më shumë se 1400 vjetësh e që na përshkruajnë hollësisht krijimin dhe shumë fenomene të tjera, të cilat ishin të pamundura që të njiheshin në atë kohë?

Shkenca bashkëkohore sot është dëshmitare për këtë duke na sqaruar atë që Kur'ani e përmendi para 1400 vjetësh. Çfarë mendoni ju mbi këtë?

PROFESOR HAJ

"Jam shumë i impresionuar që gjenden të tilla dije në Kur'anin famëlartë. S'mund ta di se nga kanë ardhur ato.

Është shumë interesante që këto vargje shkencore gjenden në Kur'an dhe vazhdimisht po punohet në zbulimin e domethënies të vargjeve të tij."

- Domethënie ju e mohoni se këto vargje kur'anore mund të jenë produkt i mendjes njerëzore. Atëherë nga kanë ardhur këto njohuri?

PROFESOR HAJ u përgjigj:

"Besoj se vërtet këto janë prej Zotit" Prof. EZ ZENDANI
Pra, Kur'ani është fjalë e Zotit, i cili iu shpall Muhammedit ﷺ I
dërguari i fundit i Allahut, Muhammedi ﷺ ka thënë:

"Allahu çdo të dërguari të Tij, i dha atë që e besonin njerëzit.
Kurse mua m'u dha Kur'ani, Shpallja e Allahut. Lus që te kem
numrin më të madh të ithtarëve në Ditën e Gjykimit."²

Ky është Kur'ani, mrekulli e përsosur dhe argument i qartë për
mbarë njerëzimin deri në ditën e Gjykimit.

"Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit! "

"Atyre që u është dhënë dija, e dinë se kjo që të është shpallur ty
nga Zoti është e vërtetë dhe se udhëzon në rrugën e Fuqplotit, të
Lavdëruarit." (Sebe, 6)

² Oqeanografi i famshëm francez, Jacques Yvés-Cousteau (Zhak Kusto) që e ka kaluar eten e tij ne zbulimet e nëndetit dhe që konsiderohet një autoritet i madh ne këtë fushë, shpjegon:

"Po merrnim ne analizë disa hipoteza ne lidhje me pengesat që ndantë nga njëra-tjetra masat ujore te dy deteve te ndryshëm. Ne fund te kërkimeve pamë se si masa ujore, ashtu edhe veçoritë si te Detit Mesdhe, ashtu edhe te Oqeanit Atlantik, ishin te ndryshme nga njëra-tjetra. Sipas fakteve, këto dy masa ujore, bashkohen ne Ngushticën e Gjibraltarit, ku, përqindja e kripës dhe dendësia e tyre duhet te ishin te barabarta. Por pemë që një gjë e tillë, përgjatë zonave te takimit te te dy deteve nuk po ngjiste aspak. Pra, ujrat nuk po përziheshin me njëri-tjetrin. Si përfundim i kërkimeve që ne bëmë, rezultoi se ekziston një pengesë e mahnitshme ujore që pengonte përzierjen e ujrave. Kapiten Costeau këto ia shpjegoi mikur te tij, i cili që më pare ishte bërë musliman, Dr Maurice Bucaille. Ky, pasi i thotë që kjo dukuri nuk është diçka e te dhe se këtë Kur'ani i Madhëruar e ka shpjeguar qysh para 14 shekujsh ne mënyrë te qartë, Costeau, i cili, i mahnitur nga kjo, tha keto fjalë: Dëshmoj se me te vërtetë Kur'ani është Fjala e Zotit. Kështu, ai u be musliman. Transmeton Buhariu ne "vlerat e Kur'anit, kapitulli 1- hadithi 4981 nga Ebu Hureje.

PJESA E NËNTË SHFAOJA E SËMUNDJEVE DHE EPIDEMIVE ME PARAOITJEN E AMORALITETIT

PROF. PARSAN

"Unë nuk e kam të vështirë të pranoj se ky është Y frymëzim ose shpallje, i cili i është zbritur Muhammedit ﷺ për sqarimin e çështjeve. "

PROF. EZ ZENDANI

- Ky është profesor PARSAN, përgjegjës i anatomisë në fakultetin e mjekësisë në Kanada. Me të na njohu doktor MUR. Doktor Mur na tha se ka dijetar objektiv të cilëve u intereson e Vërteta, e ndër ta është edhe profesor Parsan.

Ky profesor është autor i njohur. Ka disa libra, që i ka shkruar në fushën e gjinekologjisë. Në këto libra ai ka shtuar disa nga ato që janë përmendur në Kur'an dhe në thëniet e Muhammedit ﷺ. Ai paraqiti një numër studimesh në disa simpoziume, në mes të cilave është edhe seminari i tij i mbajtur mbi thëniet e Muhammedit ﷺ të cilat i transmeton koleksionuesi i njohur i haditheve, Muslimi.

Muhammedi ﷺ thotë: "Kur embrioni ben 42 netë, Allahu dërgon engjëllin, i cili i jep formën atij, i krijon të dëgjuarit, te parit, mishin, liëkuren dhe eshtrat, pastaj engjëlli thotë:

O Zoti im, mashkull apo femër? Zoti yt ben ate që do. "

Sikurse e shohim në këtë forografi kjo pamje e pikës së ujit (spermës) është në ditën e 35-të. Në këtë kohë nuk dallojmë formën e njeriut.




fig. 12 embrioni – 35 fig. 13 embrioni - 42

Kjo fotografi që shohim tani është bërë, kur embrioni mbushi 42 ditë. Deri tani, sikurse thotë profesor Parsan, nuk vërehet aspak pamja e njeriut. Tani shohim këtë fotografi të qartë, të cilën na e ka ofruar kompania "SIBA". Kjo kompani këtë fotografi të embrionit, kur ai mbushi 42 ditë ua ofroi mjekëve të gjithë botës.

Pas kësaj jave, konkretisht në javën e 7-të, pikërisht pas ditës së 42-të ndryshon pamja e embrionit, siç shihet në fotografi. Fjalët e Muhammedit ﷺ të cilat i dëgjuam më parë thonë: "Kur embrioni mbush 42 netë, Allahu dërgon engjëllin, i cili i jep formën atij, i krijon të dëgjuarit, të parit, mishin, lëkurën dhe eshtrat..." ashtu siç e pamë më parë në fotografi.

Profesor Parsani paraqiti studime mbi lidhshmërinë e Kur'anit dhe shkencës bashkëkohore. Në mes të studimeve të tij është edhe studimi mbi përmbajtjen e fjalëve të Muhammedit ﷺ, të cilat na i transmeton Hakimi dhe Bejhekiu.

Muhammedi ﷺ thotë:

"Sa herë që shfaqet imoraliteti në mënyrë të hapur ne një popull, tek ai popull do të bien epidemi dhe shumë sëmundje të tjera që nuk ekzistojnë më parë."

PROFESOR PARSAN na shpjegon një pjesë nga punimi i tij. Ai thotë:

"Tani është pranuar se ndryshimet negative që ndodhin në mitër kanë të bëjnë me moshën e grave, nu -mrin e marrëdhënieve seksuale dhe numrin e lindjeve. Marrëdhëniet intime reciproke janë shumë të rëndësishme. Dashuria e shfrenuar mund që në një shkallë të madhe të shkaktojë kancerin. Pasoja dhe rreziku nga marrëdhëniet jo legjitime seksuale si dhe marrëdhëniet seksuale në mënyrë jo të rregullt janë përmendur nga Muhammedi ﷺ që para 1400 vjetësh."

Besoj se jam në rregull. Sa here që shfaqet imoraliteti në mënyrë të hapur në një popull, tek ai popull do të bjerë epidemia dhe shumë sëmundje të tjera që nuk ekzistojnë më parë.

Fjala "fahishe" e përdorur në hadith nënkupton tradhtinë, homoseksualizmin, pederastinë, lesbizmin e të gjitha format e tjera të amoralitetit.

Dëshmi për këtë janë edhe sëmundjet e kohës së sotme ndër të cilat është SIDA dhe HERPESI" PROF. EZ ZENDANI

Ky është shpjegimi që i bëri profesor PARSAN fjalëve të Muhanimedit ﷺ: "Sa herë që shfaqet imoraliteti në mënyrë të hapur në një popull, tek ai popull do të bien epidemia dhe shumë sëmundje të tjera që nuk ekzistojnë më parë. "

Në Amerikë dhe Evropë, pasi u legjitimua homoseksualizmi, prostitucioni dhe imoraliteti me të gjitha format e tij, me shpejtësi filluan të përhapen sëmundje të cilat po kërcënojnë ardhmërinë e këtyre vendeve.

Të vërtetën e ka thënë i dërguari i Allahut, Muhammedi ﷺ Këto janë sëmundje të reja të cilat përhapen mes njerëzve duke mbjellur tek ata frikë dhe panik.

Profesor PARSAN dha një kontribut të madh në këtë aspekt.

Kur u kërkua mendimi i tij mbi këtë fenomen, të cilin e njohu vetë dhe mori pjesë me studimet e tij.

PROF.PARSAN tha:

"Më është shpjeguar se Muhammedi ﷺ ishte njeri i zakonshëm dhe nuk dinte shkrim e lexim. Ai jetoi para më shumë se 1400 vjetësh, ishte analfabet e dha sqarime dhe shpjegime të thella dhe të detajuara (hollësishme) që përputhen çuditërisht me shkencën.

Unë personalisht nuk mund të them se kjo u bë rastësisht. Ka shumë gjëra që janë përmendura saktësisht. Prandaj sikurse doktor MURI dhe unë s'e kam të vështirë që të pranoj me logjikën time se Kur'ani është frymëzim ose SHPALLJE HYJNORE që i është dhënë Muhammedit ﷺ për sqarimin e çështjeve."

PROF EZ ZENDANI

Po, Kur'ani është SHPALLJE E ZOTIT, të cilin e zbriti nga dija e Tij.

"Allahu dëshmon për atë që ta zbriti ty, i cili ta zbriti nga dija e Vet. " (En-Nisa: 166)

Kur'ani është udhëzim, dëshmi dhe argument, është udhërrëfyes dhe atij i drejtohem. Është e vërtetë e amshueshme, deri në Ditën e Gjykimit.

"Ne emër te Allahu, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit!

"Atyre që u është dhënë dija, e dinë se kjo që të është shpallur ty nga Zoti është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e Fuqplotit, të Lavdëruarit!" (Sebe, 6)

PJESA E DHJETË

TE DHËNA NATYRORE DHE GJEOGRAFIKE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Si mund t'u sjellim argumente mbi fenë islame atyre të cilët nuk e flasin gjuhën arabe dhe nuk e njohin mrekullinë gjuhësore të Kur'anit në origjinalin e tij, në gjuhën arabe!?

A duhet që edhe ata që nuk e njohin gjuhën arabe, ta mësojnë atë dhe t'i përvetësojnë shkencat e saj, në mënyrë që të kuptojnë mrekullinë gjuhësore të Kur'anit.

S'ka dyshim se Allahu është i Mëshirshëm ndaj atyre që nuk e njohin gjuhën arabe, prandaj solli argumente të mjaftueshme në Kur'an për të gjithë njerëzit, të cilët janë të ndarë në popuj, flasin gjuhë të ndryshme, jetojnë në vende dhe kohë të ndryshme. Sot me ne është profesor BALMAR, njëri prej dijetarëve më të njohur të gjeologjisë në SHBA. Ishte kryetar i shoqatës, e cila organizoi kremtimin e 100-vjetorit të shoqatës gjeologjike amerikane.

Kur u takuam me të i treguam për mrekullinë shkencore të Kur'anit dhe të Sunnetit (thënieve të Pejgamberit ﷺ). U befasua. Më kujtohet një rrëfim i bukur.

Fillova me të duke i thënë se Kur'ani përmend pjesën më të ulët të sipërfaqes tokësore dhe tregon se kjo gjendet afër xhamisë "AKSA", në KUDS (Jerusalem).

Kur'ani përshkruan betejën e cila u zhvillua në mes persianëve dhe bizantinëve dhe në këtë përshkrim aludohet për atë që thamë më parë.

Në Kur'anin famëlartë, lexojmë:

"Elif, Lam, Mint! Bizantinët u mundën në pjesën me te **ulet**, por pas disfatës si! tyre ata do të ngadhënjëjnë " (err Rrum, 1, 3)

Fjala e përdorur në vargun kur'anor "EDNA" nënkupton "pjesën më të afërt" dhe "pjesën më të ulët".

Komentatorët e Kur'anit, Allahu qoftë i kënaqur me ta, e kanë komentuar këtë fjalë sipas shpjegimit të parë, duke thënë se me këtë nënkuptohet pjesa më e afërt me tokën arabe. Mirëpo kjo fjalë ka edhe kuptimin e dytë, pra nënkupton edhe pjesën më të ulët. Kështu në Kur'anin famëlartë një fjalë përmban në vete shumë kuptime dhe çdo kuptim ka domethënien e vet. Muhammedi ﷺ thotë:

"Më është dhënë të folurit përmbledhës".

Kur studiuam pjesën më të ulët të sipërfaqes tokësore, zbuluam se kjo është pjesa në të cilën u zhvillua kjo betejë.

"Bizantinët u mundën në pjesën më te ulet

Kur i treguam për këtë profesor Balmarit, ai tha:

-Jo, ka shumë vende më të ulta se kjo pjesë dhe përmendi disa vende në Evropë dhe Amerikë.- Ne i thamë:




fig. 14

Ultësirat tokësore nën sipërfaqen detit të shënuara në metra.
(Biblioteka e Libanit – Beirut Atlasi botëror, faqe 95)

Doktor ne e kemi verifikuar këtë gjë. Ai kishte globin, në të cilin ishin shënuar vendet më të larta dhe më të ulta tokësore. Pastaj ai tha se kjo gjë është e lehtë, se ky glob na tregon vendet më të ulëta dhe e rrotulloi globin që ta shihnim atë pjesë rreth xhamisë "AKSA" në KUDS (Jerusalem). Aty shihej një shigjetë e cila tregonte se aty gjendej pjesa më e ulët e rruzullit mbi sipërfaqen e globit. Shpejt ndryshoi dhe tha se kjo është e vërtetë. Pastaj filloi të shpjegojë duke folur mbi globin dhe tha se vërtet kjo pjesë është më e ulëta në sipërfaqen tokësore.

"Vërtet, kjo pjesë e cila gjendet pranë Detit të Vdekur, është pjesa më e ultë" PROF. EZ ZENDANI

Profesor BALMARI u magjeps, kur pa se Kur'ani e përshkruan të kaluarën, se si ka filluar krijimi i tokës, se si janë formuar malet dhe se si mbijnë bimët. Se si Kur'ani përshkruan të gjitha këto, malet dhe ato që gjenden mbi to, pastaj përshkruan gjendjet në të cilat kaloi toka, ajo që ndodhi në gadishullin arabik, ai përshkruan gjendjen e vendeve arabe dhe të rruzullit tokësor në të ardhmen.

Profesor Balmar thotë se ky libër është i çuditshëm. Ai na përshkruan të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Mirëpo ashtu si edhe dijetarët e tjerë ai nuk ka qëndrim të prerë në fillim, po më vonë ata e shprehin atë që besojnë. Kështu ai në Kajro paraqiti seminarin e tij rreth mrekullisë shkencore të Kur'anit famëlartë në shkencat e gjeologjisë.

PROF. BALMAR seminarin e tij e përfundoi me këto fjalë:

"Unë nuk e di se në çfarë shkalle të kulturës ishin njerëzit që jetonin në kohën e Muhammedit ﷺ, nuk e di as nivelin e tyre shkencor.. Nëse gjendja ishte ashtu si edhe tek popujt e tjerë ku

njohuritë ishin në një shkallë shumë të ulët, ku s'kishin mundësitë e sotme, s'ka dyshim se këto njohuri të cilat ne i lexojmë sot në Kur'an janë DRITË nga DIJA e ALLAHUT, të cilin Allahu ia shpalli Muhammedit ﷺ".

Ai përfundoi duke thënë:

"Jam marrë me studimin e historisë së hershme të Lindjes së Mesme dhe nuk kam hasur të dhëna të tilla dhe përderisa në atë kohë s'kishte kësioj të dhëna, ky fakt na forcon bindjen se Allahu nëpërmjet Muhammedit dërgoi pak dije nga dija e Vet, të cilën kohët e fundit po e zbulon shkenca modeme. Ne do të vazhdojmë të merreni me aspektin gjeologjik në Kur'an."

PROF. EZ ZENDANI

Kështu pëfundon profesor Balmar. Ky është një prej dijetarëve më të njohur të gjeologjisë së sotme në SHBA.

Ai është këmbëngulës që të pranojë të vërtetën, ta paraqesë atë dhe ta shpjegojë, por ka nevojë për një që t'ia tregojë të vërtetën.

Në Perëndim dhe Lindje u zhvillua një luftë e pandërprerë në mes religjionit dhe shkencës. Kjo patjetër duhej të ndodhte, sepse të gjitha religjionet e mëparshëm u shtrembëruan dhe u devijuan.

Prandaj Allahu i madhëruar ia shpalli Muhammedit ﷺ Kur'anin që të përmirësojë atë që u shtrembërua dhe u devijua më parë nga dora e njeriut.

Ndoshta dikush pyet: Si mund të pranojnë njerëzit nga ne fenë islame, kur ne kemi ngelur prapa dhe nuk i përmbahemi plotësisht fesë sonë?!

Përgjigja është se dija ua hap sytë dijetarëve dhe ata i shohin të vërtetat shkencore në Kur'anin famëlartë dhe shohin realitetin e muslimanëve.

Është shkenca ajo që në mënyrë të vazhdueshme po e lartëson Islamin dhe janë dijetarët e mëdhenj ata të cilët po përuhin kokat e tyre në shenjë respekti ndaj Kur'anit, librit të Allahut dhe thënieve të Muhanimedit ﷺ

Njerëzit të cilët Allahu i krijoi me natyrë të pastër mund të jenë të qetë vetëm duke besuar në fenë e vërtetë. Njerëzit pa besim të drejtë janë të shqetësuar dhe të tronditur shpirtërisht.

Sot jetojmë në kohën kur çdokush e shpreh atë që beson. Kur dijetarët e kuptojnë të vërtetën ata e shprehin atë pa marrë parasysh asgjë.

Gjatë emisioneve tona dëgjuam dijetarë të cilët e pranuan mrekullinë e kohës sonë, mrekullinë e gjallë e të përhershme derisa të jetë jeta.

Ata e pranuan Kur'anin famëlartë.

"Në emër të Allahut, Bamiresit të përgjithshëm, Mëshiruesit" "

"Atyre që u Ushte dhënë dija, e dine se kjo që te është shpallur ty nga Zoti yt është e vërtetë dhe se udhëzon në rrugën e Fuqiplotit, te Lavdishmit!" (Sebe, 6)

PJESA E NJËMBËDHJETË KODRAT

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botë rave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Tani do të takohemi me profesor SIJAVIEJ, një ndër dijetarët më të shquar të gjeologjisë dhe hidrologjisë në Japoni. Ai është gjithashtu një ndër dijetarër më në zë në botë. Në fillim tek ai hasëm dyshime rreth të gjitha religjioneve. Ai nuk i besonte asnjë religjioni, madje kishte qëndrim indiferent ndaj tyre. Qëndrimi i tij ndaj religjioneve ishte i arsyeshëm, por jo edhe ndaj fesë islame, sepse feja islame ndryshon nga të gjitha fetë e tjera.

Kur u takuam për herë të parë na tha: nuk bën që dijetarët e fesë të flasin, ata duhet të heshtin plotësisht për sa u përket çështjeve të kësaj bote.

- E pyeta: Pse profesor?

- Ai tha: Sepse kur flisni ju dijetarët e fesë, ndizni luftëra në mes njerëzve në botë.

I thashë: Po Pakti i Varshavës dhe ai Atlantik pse kanë gjithë ato baza të mëdha ushtarake, armatime nukleare, flota detare, po luftëra e yjeve, armët e vendosura mbi tokë e nën tokë? Pse gjithë kjo? Mos vallë kjo bëhet nga dijetarët e fesë? Ai heshti.

I thashë: Sido që të jetë unë e di arsyen e një qëndrimi të tillë që ju mbani ndaj të gjitha feve. Por dëshiroi që së pari të dëgjosh dhe të shohësh me sytë e tu, sepse ti nuk e njeh fenë islame.

I drejtova një numër pyetjesh në sferën e specializimit të tij, me çka janë të lidhura disa vargje kur'anore dhe thëniet e Muhammedit ﷺ të cilat përshkruajnë dukuritë mbi të cilat flisnim ne. Nga ai kërkuam që të flas rreth maleve.

E pyeta si është forma e malit? A s'është në formë shtylle? PROF. SIJAVEJ U përgjigj:

"Malet kontinentale dhe ato oqeanike përbëhen nga komponentë adekuate varësisht se për cilin mal bëhet fjalë. Malet kontinentale në esencë përbëhen nga komponentë të forta, kurse malet oqeanike përbëhen nga shkëmbinjtë vullkanikë. Edhe pse përbërja e tyre është e ndryshme, është me rëndësi që të themi se të dy këto lloje malesh shërbejnë për qëndrueshmërinë e kores së tokës. Malet kontinentale u formuan nën ndikimin e forcave centripetale, kurse malet oqeanike janë formuar nën ndikimin e forcave centrifugale. Ajo që është e përbashkët për të dy llojet e maleve është fakti se ato kanë baza në të cilat mbështeten. Përsa u përket maleve kontinentale, lënda e dendur prej së cilës përbëhet mali shtrihet nën tokë dhe i përngjan rrënjës, ndërsa përsa u përket maleve oqeanikë, lënda e tyre e butë është e nxehtë dhe prandaj ajo arrin të shtrihet në mënyrë të lëngët duke shëmbyer si mbështetje për malin. Nga e tërë kjo nxjerrim se roli i rrënjëve të dy llojeve të maleve është mbështetja e tyre, në përputhje të plotë me ligjin e Arkimedit.

Profesor Sijavej thotë se secili nga këto male, qoftë në vende të thata kontinentale ose në brendinë e oqeanëve kanë formën e shtyllës.




fig. 15

Por a e dinte ndokush këtë gjë në kohën e Muhammedit ﷺ?

A mund të imagjinojë njeriu që ky mal kaq i madh, të cilin e shohim mbi sipërfaqen tokësore të shtrihet edhe në brendinë e tokës dhe të jetë në formë shtylle? Librat e mëparshëm që flasin mbi gjeografinë dhe gjeologjinë, malet i përshkruajnë vetëm në pjesën e sipërme të tyre, mbi sipërfaqen e tokës. Shkenca bashkëkohore ka zbuluar se futja e maleve në brendi të tokës është, shumëfish më e madhe se ajo që është mbi sipërfaqen tokësore.

Allahu i madhëruar në Kur'anin famëlartë, rreth maleve thotë:

"Dhe malet i beme shtylla." (En-Nebe'e, 7)

Kur e pyetëm prof. Sijavej mbi rëndësinë e këtyre maleve dhe rolin e tyre në qëndrueshmërinë e kores së tokës, ai tha se deri më sot shkenca nuk e ka zbuluar këtë gjë. Ne filluam të gjurmojmë dhe të pyesim rreth kësaj çështjeje. Pjesa më e madhe e gjeologëve na dhanë të njëjtën përgjigje, përveç një numëri të vogël. Ndër ta janë autorët e këtij libri të cilin po e shohim.. Ky përdoret si manual në shumë universitete të botës. Një nga ata që mori pjesë në përpilimin e këtij libri, është FRANK PRES. Tani ai është kryetar i shkencave akademike në Amerikë. Më parë ishte këshilltar shkencor i ish-kryetarit amerikan Xhimi Karter.

Ç'thotë ky libër? Në faqen 488 na sqaron formën e malit, i cili është në formë shtylle. Gjithashtu në faqen 413 shihet pjesa e sipërme të kodrës mbi sipërfaqen tokësore, kurse në sipërfaqen tokësore ajo futet në formë shtylle.

Në vizatimin e vendosur në faqen 435 shohim se shkruhet mbi rëndësinë e maleve.

"Ai thotë se malet luajnë një rol të madh në përf forcimin e

qëndrueshmërisë së kores së tokës". Këtë Kur'ani famëlartë e ka thënë para më shumë se 1400 vjetësh.

Allahu i madhëruar në Kur'an thotë:

"Dhe malet Allahu i ka ngulitur fort!"

“A nuk e bëmë Ne token të përshtatshme (për jetë), ndërsa kodrat shtylla ? " (en.Nebe'e 6,7)

"Allahu vendosi malet e forta ne tokë që ajo të mos lëkundet me ju"

Kush e njoftoi Muhammedin ﷺ mbi këtë gjë? (En Nahl 15)

Pastaj e pyetëm profesor Sijavej, duke i thënë: Profesor, çfarë mendoni mbi këtë fenomen, mbi fenomenin kur'anor dhe fjalët e Muhammedit ﷺ rreth sekreteve të universit? Këtë gjë shkencat e zbuloi në kohën tonë.

PROFESOR SIJAVEJ na u përgjigj duke thënë:

"Më duket shumë misterioze, shumë. Madje gati e pamundshme që të besoj si të vërtetë atë që the. Vërtet Kur'ani meriton vëmendje dhe kujdes. Unë pajtohem me ty rreth kësaj"

PROFESOR EZ ZENDANI

Çfarë të thonë dijetarët? Këtë dije të cilën Allahu ia zbriti Muhammedit ﷺ në këtë libër s'mund të jetë produkt i mendjes së ndonjë njeriu ose të jetë rezultat i të dhënave shkencore të asaj kohe. Ata s'kanë komentim tjetër veçse të thonë se ky vjen prej një burimi tjetër i cili qëndron jashtë universit.

Vërtet Kur'ani është shpallje nga Allahu që ia shpalli robit të Tij, Muhammedit ﷺ Është mrekulli e përhershme që do të vazhdojë sa të ekzistojë njerëzimi, deri në Ditën e Fundit.

"Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit! "

"Atyre që u është dhënë dija, e dine se kjo që te është shpallur ty nga Zoti është e vërtetë dhe se udhëzon ne rrugën e Fuqplotit, të Lavdëruarit!" (Sebe, 6)

PJESA E DYMBËDHJETË TE VËRTETA ASTRONOMIKE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muharnmedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Allahu i madhëruar na shpjegon se këtë libër, Kur'anin e zbriti si mëshirë për të gjitha botërat, Ai thotë:

"Ky Kur 'an nuk Ushte gjë tjetër, veçse këshillë për botërat. Ju gjithsesi do ta kuptoni vërtetësinë e tij, qoftë pas pak kohe"

Kur'ani është përkujtues për mbarë njerëzimin. Në të ka të dhëna dhe njohuri të cilat shpjegohen me kalimin kohës. Ky Kur'an ka zbritur nga dija e Allahut. Çdo varg në të është dhënë nga dija e Tij.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

"Po Allahu dëshmon për atë që t'u zbrit ty, atë ta zbriti sipas dijes se Vet" (en. Nisa, 166)

Pra, Kur'ani është fjalë e Zotit. Çdo varg në të është nga dija e Tij. Njerëzimi me përparimin e tij shkencor po arrin të zbulojë vazhdimisht dijen hyjnore nga e cila kanë zbritur këto vargje kur'anore. Kështu që sa më shumë ata përparojnë në shkenca të ndryshme, aq më shumë u bëhet e mundur që të kuptojnë vërtetësinë e Kur'anit të shenjtë.

Shkenca bashkëkohore po zbulon shumë të vërteta të universit, të cilat janë përmendur në vargjet kur'anore. Njerëzimi vazhdimisht në Kur'an po zbulon të vërtetat e panumërta shkencore që dëshmojnë se Kur'ani është shpallje nga Allahu.

Ky është profesor Armstrong njëri nga dijetarët më të njohur të astronornisë në SHBA. Ai punon në agjensinë e fluturimeve

kozmiqe "NASA".

U takuam dhe e pyetëm mbi shumë çështje të universit që i përkasin sferës së specializimit të tij. E pyetëm se si është formuar hekuri.

PROF ARMSTRONG tha:

"Do t'ju flas se si janë formuar të gjithë elementët mbi sipërfaqen e tokës. Kemi zbuluar, madje janë bërë shumë prova që kanë vërtetuar këtë që do t'u them. Për të formuar trupa të vegjël prej thërmijave elementare, elektroneve, protoneve etj. duhet një fuqi shumë e madhe. Sipas llogaritjeve tona fuqia që nevojitet për ndërtimin e elementit të hekurit është 4 herë më e madhe se fuqia e sistemit tonë diellor.

Pra, nuk mjafton fuqia e Tokës e Diellit, e Hënës madje dhe fuqia e tërë sistemit diellor është e pamjaftueshme, por nevojitet një fuqi 4 herë më e fortë se fuqia e sistemit tonë diellor që të formohet elementi i hekurit."

Pastaj ai vazhdoi duke thënë:

"Për këtë arsye dijetarët mendojnë se hekuri është element i huaj, i ardhur në Tokë dhe nuk është krijuar në të."

Ne i lexuam fjalët e Allahut të Madhëruar:

"Dhe ne e zbritëm hekurin ne te cilin ka force te forte dhe dobi për njerëzit" (el Hadid, 25)

Pastaj e pyetëm se a ka në qiell plasaritje?

Ai tha: - Jo... Ju po flisni për njërën nga disiplinat e astronomisë. Universi është i plotë. Këtë gjë dijetarët e zbuluan kohët e fundit. Nëse një trup në hapësirë përshkon një largësi të caktuar dhe të njëjtën largësi e përshkon në drejtim të kundërt, do të vërejmë se pesha e këtij trupi në këto dy drejtime është e njëjtë,

sepse ky trup është i ekuilibruar, prandaj dhe forcat shtytëse në të gjitha anët janë të njëjta. Sikur të mos ekzistonte ky ekuilibër në univers do të kishte përplasje dhe plasaritje.

I kujtuam fjalët e Allahut të madhëruar:

"A nuk shikojnë ata me vëmendje qiellin, se si mbi ta kemi ndërtuar atë dhe e kemi zbukuruar, duke mos pasur në të ndonjë plasaritje. "

Biseduam me të gjithashtu mbi përpjekjet e dijetarëve për të arritur skajet e universit dhe mbi atë se deri ku është arritur me këto përpjekje.

PROF. ARMSTRONG tha:

"Ne po mundohemi që të arrijmë skajet e universit, vazhdimisht po i përsosim teleskopët dhe përmes tyre po zbulojmë yje dhe po kuptojmë se ende gjendemi brenda këtyre yjeve dhe se nuk i kemi arritur skajet e universit."

- I përmendëm fjalët e Allahut të madhëruar:

"Ne qiellin më të afërt (te tokës) e kemi zbukuruar me yje ndriçuese dhe ato i kemi bërë gjuajtës kundër djajve. (el-Mulk, 5).

Pra, të gjitha këto yje janë zbukuruese të qiellit të parë, kurse profesori tha se ata akoma nuk i kanë arritur skajet e universit. Ai gjithashtu tha:

"Ne mendojmë të vendosim teleskopë në hapësirë në mënyrë që pluhuri dhe kushtet atmosferike që gjenden të mënjanohen dhe të mos paraqesin pengesë. Teleskopët e deritanishëm nuk mund të kalojnë largësitë e afërta, prandaj ata i kemi zëvendësuar me stacione kozmike që i kemi vendosur në hapësirë. Nëpërmjet tyre kemi shkuar më tej, por akoma gjendemi shumë larg.

I kujtova fjalët e Allahut të madhëruar:

"Drejto shikimin (ne drejtim te qiellit) nëse sheh ne të ndonjë plasaritje... Mandej herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet tek ti i përulur dhe i molisur." (el Mulk, 3,4)

Për çdo gjë ne i sillnim vargje kur'anore. Sa here që ai përmendte ndonjë të vërtetë ne i sillnim vargje kur'anore, me të cilat ai pajtohej plotësisht. Pastaj i thamë: Të vërtetat e astronomisë bashkëkohore njeriu i zbuloi duke përdorur mjetet më bashkëkohore si satelitët, anijet kozmike etj. Këto të vërteta janë përmendur në Kur'an para më shumë se 1400 vjetësh. Çfarë mendoni për këtë gjë?

PROF. ARMSTRONG u përgjigj:

"Kjo pyetje është e vështirë. Rreth saj kam filluar të mendoj që kur kemi filluar të diskutojmë. Unë jam shumë i impresionuar, se si ky libër përputhet plotësisht me astronominë bashkëkohore, gjë që zgjon kureshtjen e dijetarëve. Nuk kam dije të mjaftueshme rreth historisë së njerëzimit aq sa të imagjinoj periudhën e para 1400 vjetëve. Por dua të them se ajo që lexuat është vërtet shumë interesante. Është e pamundur që ato të jenë rezultat i të dhënave shkencore të asaj kohe. Mbase mund të qëndrojnë diçka tjetër pas të kuptuarit tonë. Por s'kam qëllim e s'mund të ofroj përgjigje për këtë. Thashë shumë fjalë pa e theksuar atë që kërkoni ju. Detyra ime është që si dijetar të jem i pavarur në disa pyetje të caktuara. Besoj se përmbajtja e fjalëve të mia s'është shumë e kënaqshme dhe jo ajo që ju dëshironi."

PROF. EZ ZENDANI

Është vështirë të mendohet, dhe të besohet që kjo dije që gjendet në librin e Allahut që iu shpall Muhammedit ﷺ para 1400 vjetësh, të jetë produkt i mendjes së njeriut. Domosdo ky duhet të jetë nga një burim që qëndron mbi të menduarit e

dijetarëve. Ai është nga Allahu, i Cili i di të fshehtat në qiej e në Tokë.

Gjatë emisioneve tona, në takimet me dijetarë të ndryshëm pamë se si pajtohet feja e vërtetë me shkencën. Në mes shkencës së vërtetë dhe fesë së vërtetë, gjejmë fesë islame s'mund të ketë kundërrënie. Si është e mundur që dy të vërteta të kundërshtohen në mes tyre?!

Nëse një fe, cilado qoftë ajo bie ndesh me shkencën, kjo është rrjedhojë e devijimeve dhe shtrembërimeve që janë bërë në atë fe. Këtë të vërtetë e kanë konfirmuar dijetarët muslimanë gjatë shekujve.

E vërteta shkencore s'mund të kundërshtojë të vërtetën fetare islame.

Shekulli në të cilin po jetojmë nga dijetarët është quajtur shekulli i atomit. Pra, gjendemi në prag të një shekulli edhe më të rëndësishëm, shekullit në të cilin do të përputhen të vërtetat shkencore dhe të vërtetat islame.

LAVDËRUAR QOFTË ALLAHU I CILI KUR'ANIN
E RUAJTI NGA ÇDO DEVIJIM DHE SH TREMBËRIM!

"Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit! "

"Atyre që u është dhënë dija, e dinë se kjo që të është shpallur ty nga Zoti Wshti e vërtetë dhe se udhëzon në rrugën e Fuqplotit, ti Lavdëruarit." (Sebe, 6)

PJESA E TREMBËDHJETË ETAPAT EMBRILOGJIKE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Ky është profesor XH. S. Gorenger, profesor në fakultetin e mjekësisë, dega e anatomisë, në universitetin Xhorxh Taun, në Uashington.

U takuam me këtë profesor dhe e pyetëm se a është përmendur në historinë e embriologjisë fakti se njeriu zhvillohet në disa perioda. A ka libra që kanë lidhje me embriologjinë dhe që i kanë përmendur këto perioda në kohën e Muhammedit ﷺ gjegjësisht në shekullin e 7-të ose pak më vonë?

Zhvillimi i embrionit në perioda a nuk është zbuluar në shek. 19-të? PROF. GORENGER u përgjigj:

-Grekët e vjetër u munduan që ta studiojnë embrionin, disa prej tyre u munduan që t'a përshkruajnë atë që pëson embrioni. I thamë se ne e dimë se pati disa teori në mes të cilave dhe teoria e Aristotelit, por a pati në atë kohë apo më vonë ndonjë i cili përmendi se embrioni gjatë zhvillimit të tij kalon disa perioda. Ne e dimë se këto perioda u zbuluan në shek. e 19-të dhe u konfirmuan në fillim të shek. të 20-të.

Pas një diskutimi të gjatë ai tha - Po kjo është e vërtetë.

-I thamë atij:- A ka terma me të cilat janë emëruar këto perioda sikurse janë emëruar në Kur'anin famëlartë?

-Ai tha: Jo.

I thamë: Atëherë çfarë mendoni mbi këto terma kur'anore që i

emërtojnë periodat e embrionit? Pas një diskutimi të gjatë ai paraqiti seminarin e tij, në simpoziumin e 8-të të mjekësisë në Arabinë Saudite. Ai foli mbi periodat e përmendura në Kur'an dhe mosnjohjen e tyre nga njerëzit deri në kohën e sotme, mbi përshkrimin e saktë dhe konçiz të bërë në Kur'an me fjalë që çuditërisht përputhen me shkencën e sotme. *Duke folur mbi këtë çështje prof. Gorenger thotë: "Ky është përshkrim që i është bërë zhvillimit të njeriut që nga fillimi e derisa tek ai formohen gjymtyrët, në brendësi të mitrës së nënës. Ky përshkrim dhe këto sqarime të qarta dhe përmbledhëse të çdo periode, nëpër të cilën kalon embrioni për nga vjetërsia i përket shekujve para se të bëhej përshkrimi i periodave të ndryshme të embrionit e që është përmendur nga dijet tradicionale".*

PROF EZ ZENDANI

Studimi i bërë nga Prof Gorenger rreth këtij fenomeni të cilin shkenca e zbuloi kohët e fundit, hedh poshtë pretendimet e ithatrëve të disa feve.

Ihtarët e disa feve s'e imagjinojnë krijimin e njeriut pa babë. Sipas tyre nuk mund të ketë krijesa që nuk kanë babë! Rreth kësaj çështjeje Kur'ani na shpjegon duke sjellë shembullin e Ademit ﷺ Allahu i madhëruar thotë:

"Vërtet shembulli i krijimit t! Isasë pa Mbi!, tek Allahu është sikurse shembulli i Ademit, t! cilin e krijoi nga dheu, pastaj i tha: "Bëhu", e ai - Ademi - u bë." (Ali Imran, 59).

Ne kemi tre lloje krijimesh:

- 1) Krijimi pa babë e pa nënë, sikurse është rasti i Adeniit ﷺ
- 2) Krijimi pa nënë, sikurse është rasti me hazretin HAVANE, nëna e njerëzimit;
- 3) Krijimi pa babë, sikurse është rasti me Isanë ﷺ Allahu i Gjithëfuqishëm i Cili krijoi Ademin ﷺ pa babë e pa nënë, krijoi

Isanë ﷺ pa babë. Allahu na sjell edhe shumë fakte të tjera që dëshmojnë mbi fuqinë e Tij.

Disa thonë se s'kanë parë dhe s'mund të imagjinojnë se një krijesë mund të krijohet pa babë, prandaj ithtarë profetëve të tyre u dhanë epitete të ndryshme.

Ndërkaq shkenca bashkëkohore ka zbuluar se shumë gjallesa në këtë botë shtohen dhe shumohen dhe pa fekondimin e femrës nga mashkulli. Një fenomeni tillë njihet me emrin PARTENOGENEZT, me të cilën nënkuptohet zhvillimi i një individi nga një vezë e papllenuar. Kjo haset në disa grupe shtazore. Po rasti më tipik është ai i bletës. Bleta mashkull lind nga veza e cila nuk është e fekonduar nga mashkulli. Kurse nga veza, e cila fekondohet nga mashkulli, lind bleta femër. Ndërkaq bleta mashkull lind nga veza e mbretëreshës së pafekonduar nga mashkulli. Rreth kësaj ka shumë shembuj. Përmes shkencës bashkëkohore njeriu arriti t'i zhvillojë vezët e disa krijesave pa fekondimin e krijesës mashkull.

PROFESOR GORENGER na flet mbi këtë çështje:

"Tek shumë gjallesa kuffizore, ujëtokësore dhe gjitare, veza e pafekonduar mund të nxitet dhe të zhvillohet në mënyra mekanike, sikurse është shpimi me gjilpërë ose me anë të temperaturës, apo në mënyra kimike, nëpërmjet lëndëve kimike dhe kështu veza e tyre vazhdon fazat e zhvillimit të saj. Madje tek disa lloje, kjo mënyrë konsiderohet si zhvillim i natyrshëm i embrionit."

PROF. EZ ZENDANI

Prandaj për të krishterët që thonë që njeriu s'mund të lindë pa babë, shkenca bashkëkohore e hedh poshtë pohimin e tyre. Ai sjell fakte duke dëshmuar se një gjë e tillë është e mundshme gjë që është vërtetuar gjatë eksperimenteve të ndryshme. Allahu i

Madhëruar në Kur'an solli shembullin e Ademit ﷺ të cilin e besojnë të gjitha fetë. Ademi ﷺ s'pati as nënë, as babë. Atë Allahu e krijoi nga dheu. Pra, s'është e pamundur që njeriu të krijohet pa babë ose pa nënë. Prandaj edhe ai njeri, që lind pa babë është si gjithë të tjerët, është njeri i zakonshëm.

Si Ademi ﷺ ashtu edhe Isai ﷺ u krijua nga fuqia e Allahut. Kur'ani thotë:

"Vërtet shembulli i Isasë, i lindur pa WE, tek Allahu, është sikurse shembulli i Ademit ti cilin Allahu e krijoi nga dheu, e i tha "Bëhu" e ai u bë" (Ali Imran, 59)

Deshi Allahu që shkenca bashkëkohore me zbulimet e saj të sjellë fakte duke konfirmuar të vërtetën që na solli Kur'ani famëlartë rreth kësaj çështje. Kështu vazhdimisht po konfirmohet e po vërtetohet ky libër i Zotit.

Me kalimin e kohës po vërtetohen vargjet kur'anore dhe shenjat e tij duke iu bërë e qartë dijetarëve të mëdhenj të kohës sonë dhe dijetarëve të ardhshëm se Kur'ani është i vërtetë. Ky është libër për të cilin dijetarët nuk kanë të ngopur. Mrekullitë e tij nuk kanë fund.

"Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit!

"Atyre që u Fshehtë dhënë dija, e dinë se kjo që ti është shpallur ty nga Zoti është e vërtetë dhe se udhëzon në rrugën e Fuqiplotit, të Lavdëruarit!" (Sebe, 6)

PJESA E KATËRMBËDHJETË THELLËSITË DETARE DHE OOEANIKE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave.

Paqja a dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Mrekullia e Kur'anit është e vazhdueshme dhe e përhershme derisa të jetë jeta. Ai është i kuptueshëm për njerëzit e kulturave dhe popujve të ndryshëm. Si beduini i shkretëtirës ashtu edhe profesori i universitetit gjen në Kur'an atë që i nevojitet.

Ky është profesor Derga Bursad Rav, profesor i oqeanologjisë. Tani është profesor në Universitetin "Melik Abdul Aziz" në Xhede të Arabisë Saudite. U takuam me të dhe i treguam disa vargje kur'anore dhe thënie të pejgamberit, Muhammedit ﷺ, që kanë të bëjnë me shkencën. Ai u befasua kur dëgjoi dhe lexoi kuptimin e vargjeve kur'anore rreth fenomenit shkencor.

Prof. Rav vendosi që të merret me shpjegimin e këtij vargu kur'anor.

"Si errësirat ne det te thellë, te cilën e mbulojnë vale mbi vale dhe mbi ato, retë e dendura, pra errësira njëra mbi tjetrën, sa që nuk mund ta shoh ai as dorën e vet. Atij, te cilit Allahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë." (en Nur, 40)

PROFESOR RAV shpjegoi:- Këto errësira u njohën nga dijetarët, kohët e fundit, pas përdorimit të nëndetëseve, të cilat mundësuan zhytjen në thellësitë e mëdha detare. Njeriu pa përdorimin e mjeteve zhytëse, nuk ka mundësi të zhytet në thellësinë mbi 20-30 metra. Zhytësit të cilët kërkojnë margaritarë në zonat e Gjirit Persik, zhyten në thellësira që janë më pak se 30 m. Njeriu që zhytet në thellësinë mbi 200 metra, s'mbetet i

gjallë.

Vargu kur'anor, i referohet këtij fenomeni që haset në detet e thellë. Prandaj Zoti në Kur'an thotë:

"Si errësirat në det të thellë..."

Errësirat që shtresohen njëra mbi tjetrën, në detet e thellë, formohen nga dy shkaqe. Shkaku i parë është si rezultat i humbjes së ngjyrave shtresë pas shtrese. Rrezet e dritës përbëhen nga 7 ngjyra. Kur këto rreze zbresin në ujë, ngjyrat përbërëse zbërthehen. Kështu pjesa e sipërme e detit, në thellësinë deri në 10 metra, absorbon ngjyrën e kuqe. Nëse një zhytës, zhytet në thellësinë deri në 30 metra dhe nga dëmtimi i trupit të tij del gjak, ai s'mund ta shohë gjakun e vet, sepse ngjyra e kuqe në këtë thellësi nuk dallohet. Pas ngjyrës së kuqe, uji absorbon ngjyrën portokall, kurse në thellësinë prej 50 metrash fillon të absorbojë ngjyrën e verdhë. Duke zbritur më tej, në thellësinë prej 100 metrash, uji absorbon ngjyrën e gjelbër, ndërsa në thellësinë prej 200 metrash absorbon ngjyrën e kaltër.

Pra, kemi formimin e disa errësirave në shtresat e ndryshme të ujit, të cilat janë të vendosura njëra mbi tjetrën.- Për sa i përket shkakut të dytë të errësimit, ai ndodh për arsye të pengesave të cilat pengojnë dritën, sepse një pjesë e rrezeve ndriçuese të diellit, gjatë zbritjes së tyre në tokë, thithen prej reve, kurse pjesa tjetër shpëndahet prej tyre. Kështu formohet një tjetër errësim për shkak të reve. Në fakt ky është errësimi i pare. Kur rrezet ndriçuese të diellit, zbresin në det të trazuar, ato reflektohen nga valët duke vezulluar. Prandaj kur valët e detit trazohen, shkëlqimi vezullues është i fortë në varësi nga pjerrësia e valës. Kështu valët e detit dëbojnë rrezet e dritës duke shkaktuar një tjetër errësirë. Rrezet ndriçuese që arrijnë të depërtojnë, zbresin poshtë dhe realizojnë ndarjen e detit në dy shtresa: në shtresën e sipërme, në të cilën ndodhet drita e nxehtësia dhe në shtresën e

poshtme, në të cilën gjendet errësira e ftohtësia. Këto dy shtresa ndryshojnë nga cilësitë dhe veçoritë e tyre. Madje ekziston një brez ndarës mes shtresës sipërfaqësore dhe asaj të thellë. Ky brez i brendshëm ndarës paraqet pengesë për dritën dhe e reflekton atë. Kjo gjë u bë e njohur në vitin 1900. Kështu në det gjenden errësira mbi errësira, që janë të ngjeshura njëra mbi tjetrën, si pasojë e pengesave që paraqesin retë, valët etj., dhe errësira që shkaktohen si rezultat i zbërthimit të ngjyrave përbërëse të dritës në ujë, gjë që është përmendur në këtë varg kur'anor qysh para 1400 vjetësh:

"Pra errësira njëra mbi tjetrën, sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit Allahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë. (en Nur, 40)

Në këto zona të thella ka errësira të forta dhe kur nëndetëset zbresin në këto thellësira nuk mund të shohin, prandaj përdorin burime drite akumulative për të parë.

Pra, kush e njoftoi Muhammedin ﷺ për këto mrekulli?!

Kjo ishte ajo rreth së cilës diskutoi prof Ravi. Pastaj analizuam së bashku me të, shumë ajete kur'anore që kanë të bëjnë në me sferën e specializimit të tij

E pyetëm. - Profesor, si e komentoni ju fenomenin e mrekullisë shkencore në Kur'an dhe Sunnet?! Si i mësoi Muhanunedi ﷺ këto të vërteta shkencore para 1400 vjetësh?!

PROF. RAV u përgjigj:

"Është vështirë të imagjinohet se këto njohuri kanë ekzistuar në atë kohë, pra para 14 shekujsh. Edhe pse disa gjëra përfshijnë mendime të përgjithshme, përshkrimi i disa detajeve në hollësi është gjë shumë e vështirë. Nga kjo kuptohet se kjo s'është dije njerëzore, sepse njeriu i zakonshëm s'ka mundësi t'i shpjegojë këto fenomene me kaq përpikëri. Kjo më shtyn të mendoj për

një Fuqi Mbinatyrore e Mbinjerëzore dhe më bën të besoj se këto njohuri kanë ardhur nga një burim Hyjnor"

PROF EZ ZENDANI:

Patjetër që po! Burimi i kësaj dije duhet të jetë një burim mbinatyror, që qëndron mbi fuqinë njerëzore, ashtu siç pohoi edhe prof. Ravi. Dhe kjo është e vërtetë, sepse Kur'ani është fjalë e Atij që e njeh natyrën, universin dhe sekretet e tij...

"Thuaj: Atë ta zbriti Ai, i Cili e di të fshehtën në qiej e në tokë... "

Kështu gërshetohen dëshmitë e shkencëtarëve, dëshmi pas dëshmie duke shpjeguar se ky l'bër që është dritë dhe udhërrëfyes, vërtet ka fakte dhe argumente mbi vërtetësinë e tij.

Kur'ani i shenjtë është udhërrëfyes, është argument dhe dëshmi e amshueme deri në Ditën e Gjykimit.

"Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit! "

"Atyre që u është dhënë dija e dine se kjo që te është shpallur ty nga Zoti është e vërtetë dhe se udhëzon ne rrugën e Fuqiplotit dhe të Lavdëruarit. "

(Sebe, 6)

PJESA E PESËMBËDHJETË FENOMENET DETARE NE MES ZBULIMEVE SHKENCORE DHE AJETEVE KUR'ANORE

PROF SHRUEJDER:

"Doktor Zendani, tregoi se si dijetari e vërteton në realitet atë që Kur'ani e tha para shumë shekujsh.

Të vërtetën e Kur'anit po e

zbulojnë dijetarët e kohës

sonë." EZ ZENDANI

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botrave.

Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të dërguarin tonë, Muhammedin ﷺ, familjen, shokët dhe ata që e ndjekin rrugën e tij derisa të jetë jeta.

Ky është profesor Shruvejder një ndër dijetarët e oqeanologjisë në Gjermaninë Perëndimore. U takuam gjatë një simpoziumi të organizuar nga Universiteti mbretëror Abdul Azis në Xhide të Arabisë Saudite. Nga unë u kërkua që të mbaja ligjëratën mbi fenomenin oqeanologjik në mes të zbulimeve shkencore dhe vargjeve kur'anore. Pasi e mbajta këtë ligjëratë u ngrit profesor Shruvejder në ditën e dytë që të diskutojë rreth ligjëratës sime. Ndër të tjera ai tha:

"Dëshiroj të shtoj diçka rreth ligjëratës së djeshme të doktor Zedanit. Dua të them se unë e vlerësoj këtë ligjëratë të mbajtur në këtë simpozium shkencor. Jo vetëm për besimtarët muslimanë, por edhe për mua është me rëndësi që shkencën mos ta kufizojmë si deri më sot, por t'i japim dimensione më të gjera duke e lidhur me fenë. Për mua me rëndësi është që shkenca të jetë në kuadrin e fesë".

PROF. ZENDANI.

Pastaj profesor Shruvejder vazhdoi të flasë mbi raportin në mes religjionit dhe shkencës. Ai në vazhdim flet mbi dallimin e madh të religjionit dhe shkencës, ku siç thotë ai ka mospajtime dhe kontradikta të mëdha në mes klerikëve fetarë dhe shkencëtarëve.

Mirëpo ai u befasua shumë, kur dëgjoi vargjet kur'anore dhe të vërtetat të cilat janë përmendur në këtë libër, para 1400 vjetësh.

Rreth kësaj Prof. Shruvejder vazhdoi duke thënë: "Dijetarët mendojnë se përparimi i shkencës ka hedhur dyshim rreth doktrinave fetare. Prandaj feja duhet t'i nënshtrohet shkencës. Ne këtu kemi të bëjmë me një qëndrim krejt tjetër. Doktor Zendani na shpjegoi se dijetari vërteton në realitet atë që e tha Kur'ani para shumë e shumë shekujsh. E vërteta e Kur'anit po zbulohet sot nga dijetarët bashkëkohorë. Unë jam i bindur se është me rëndësi që ky simpozium, këtë të vërtetë t'ua transmetojë dijetarëve të të gjithë popujve.

Unë jam i bindur se të gjithë pas këtij simpoziumi do të kthehen duke menduar më shumë rreth lidhshmërisë që ekziston mes oqeanologjisë dhe Kur'anit."

PROF EZ ZENDANI

Ajo që po zbulohet nga dijetarët e sotëm është përmendur para më shumë se 1400 vjetësh në Kur'anin e Madhërisëm. Shtrohet pyetja:

Kush e njoftoi Muhammedin ﷺ mbi këto, kush ia shpalli ato?

Në Kur'anin e shenjtë ka të vërteta të cilat po i zbulojnë dijetarët e kohës sonë, qofshin ata dijetarë të astrononisë, oqeanologjisë, gjeologjisë apo të çfarëdo lloj shkence, të cilat njihen në kohën tonë e që i ka përmendur Kur'ani famëlartë ose që rreth tyre

kanë aluduar fjalët e Muhammedit ﷺ

PROFESOR SHRUEJDER, pasi dëgjoi këto me bindje të plotë rreth kësaj çështje, foli duke thënë:

"Rezultatet e një dijetari nuk janë shkëputur nga ato të dijetarëve të tjerë. Nuk mund të jetë shkenca në një anë dhe feja në anën tjetër. Të gjithë ata ecin në një drejtim. Ata thonë të njëjtën gjë edhe pse në gjuhë të ndryshme, si me gjuhë të larta shkencore, me gjuhë të rëndomtë, ose me gjuhën e shenjave siç u shpreh doktor Zendani."

PROFESOR EZ ZENDANI

Ai kërkon në mënyrë të qartë, që kjo t'i tregohet gjithë botës, gjithë njerëzve e veçanërisht dijetarëve në simpoziumet e tyre shkencore në të gjitha gjuhët që ta kuptojnë këtë fenomen dhe t'u bëhet e qartë lidhshmëria e vërtetë ndërmjet fesë së padevijuar dhe shkencës së vërtetë, të cilat s'mund të ndahen nga njëra-tjetra. S'ka dyshim se feja e vërtetë, feja Islame e urdhëron marrjen e shkencës së vërtetë. Në Kur'an thuhet:

"A janë te barabartë ata që dine me ata që s'dinë?" (ez-Zumer, 9)

"Dije se s'ka Zot tjetër përveç Allahut! (Muhammed, 19)

"Thuaj: Vështroni me vëmendje çka ka nga argumentet ne qiej e ne tokë." (Junus, 101)

"Per besimtarët ka argumente ne qiej e ne tokë. Për një popull që është i bindur sinqerisht ka argumente edhe ne krijimin tuaj edhe ne krijimin e shtazëve te shpërndara. Edhe ne ndërrimin e natës dhe te ditës dhe ne riskun që Allahu lëshon prej qielli dhe me te pasi te ketë vdekur, (Toka) e ngjall atë. Dhe ne lëvizjen e errësirave ka argumente për një popull që logiikon. Këto Jane shenja te Allahut që po ti lexojmë ty, ne mënyrë te saktë. Pra, cilës fjalë përveç Fjalës se Allahut dhe shenjave te Tij, i besojnë ata?" (el Xhathije, 3-6)

Pra, feja islame na urdhëron që të merremi me shkencë, që të vështrojmë universin rreth nesh. Shkenca përulet përpara kësaj feje të vërtetë. Kështu pra, ne gjendemi në prag të një kohe të re, kohë të bashkëpunimit në mes fesë dhe shkencës, por kuptohet mes shkencës së vërtetë dhe fesë së vërtetë, që kështu të kuptohet e vërteta nga bashkëkohësit tanë.

"Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit! "

"Atyre që u është dhënë dija, e dine se kjo që te është shpallur ty nga Zoti Fshehtë e vërtetë dhe udhëzon ne rrugën e Fuqiplotit, të Lavdëruarit!" (Sebe, 6)

PJESË TE ZGJEDHURA

"Jam plotësisht i bindur, se këto fakte, Muhammedit i kanë ardhur nga Zoti, sepse këto informacione shkencore, shkenca i zbuloi kohët e fundit pas një pune shumë të lodhshme. Ky është fakt bindës për mua se Muhammedi është i dërguari i Zotit." (Keeth Moore)

"Besoj se erdhi koha që të deklaroj se: S'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi ﷺ është i dërguari i Tij." (Taxhatan Taxhason)

"Sot shkenca bashkëkohore është në gjendje të vërtetojë atë që thënie e Muhammedi ﷺ para 1400 vjetësh." (Alfred Kroner)

"...Për këtë arsye nuk shoh asgjë që e bën të pamundur të kuptuarit se kjo ishte frymëzim ose Shpallje Hyjnore, të cilën ai (Muhammedi ﷺ) arrita ta transmetojë." (Marshall Xhonson)

"Jam shumë i impresionuar me të zbuluarit e së vërtetës në Kur'anin famëlartë." (Jushjudi Kozan)

"Unë besoj se s'ka kundërshtim mes njohurive shkencore dhe shpalljes islame. Islami i përkrah dhe i nxit metodat shkencore." (Hai)

"Besoj se vërtetë këto janë prej Zotit." (Xhuli Samsun)

"Unë s'e kam të vështirë që të pranoj me logjikën time se Kur'ani është frymëzim ose shpallje Hyjnore që i është dhënë Muhammedit ﷺ, për sqarimin e çështjeve." (Parsan)

"... Përderisa në atë kohë s'kishte kësisoj të dhënash ky fakt na e forcon bindjen se Allahu nëpërmjet Muhammedit ﷺ dërgoi pak dije nga dija e Vet, të cilën kohët e fundit po e zbulon shkenca moderne. Ne do të vazhdojmë të merremi me aspektin gjeologjik në Kur'an." (Balmar)

"Më duket shumë misterioze, shumë. Madje gati e pamundshme që të besoj se si vërtetë atë që the. Vërtetë Kur'ani meriton vemendje dhe kujdes." (Sijavej)

"Është e pamundur që këto të jenë rezultat i të dhënave shkencore të asaj kohe. Mbase mund të qëndrojë diçka tjetër pas të kuptuarit tonë." (Armstrong)

"Është vështirë të imagjinohet se këto njohuri kanë ekzistuar në atë kohë, pra, para 14 shekujsh. Nga kjo kuptohet se kjo s'është dije njerëzore..."

Kjo më shtyn të mendoj për një Fuqi Mbinatyrore dhe Mbinjerëzore, e më bën të besoj se këto njohuri kanë ardhur nga një burim Hyjnor." (Rav)

"E vërteta e Kur'anit po zbulohet sot nga dijetarët bashkëkohorë. Unë jam i bindur se është me rëndësi që ky simpozium, këtë të vërtetë t'ua transmetojë dijetarëve të të gjithë popujve. Dijetarët mendojnë se përparimi i shkencës ka hedhur dyshim rreth doktrinë fetare. Prandaj feja duhet t'i nënshtrohet shkencës Ne këtu kemi të bëjmë me një qëndrim krejt tjetër." (Shruvejder)

PASTHËNIE

Bismilahi Rrahmanirr Rrahim!

Kur'ani është dhurata më e madhe e Zotit dhënë njerëzimit dhe si shpallja e fundit e Zotit ka për qëllim të rivendosë të vërtetën e amëshueshme të Zotit, ta udhëheqë njerëzimin në rrugën e drejtë, ta zgjojë vetiëdijen e njerëzimit dhe ta ndriçojë mendjen njerëzore. Ne këtë libër u trajtuan mrekullitë shkencore të disa ajeteve kur'anore, por duhet theksuar se Kur'ani çështjet shkencore nuk i paraqet në mënyrë të detajuar Ai aludon për ta në mënyrë metaforike dhe kuptimore, duke nxitur mendjen njerëzore për kërkime dhe zbulime të reja. Sa herë që shkenca, gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore, ben një hap përpara, ajo vazhdimisht gjen mbështetje në thëniet e Kur'anit dhe thëniet e tij përtërihen gjatë shekujve brez pas brezi, duke dëjshmuar se Kur'ani është libër universal dhe se thëniet e tij janë aktuale për çdo kohë.

Duhet të theksojmë se Kur'ani është një libër i mrekullueshëm dhe i pakrahasueshëm, jo vetëm për anën fetare, edukative, historike, shoqërore e mrekullitë shkencore që ai përmban, por edhe përse i përket gjuhës letrare, formës artistike, forces së lartë të të shprehurit, elokuencës, ëmbëlsisë dhe tërheqjes së jashtëzakonshme, mospranisë në të, të kontradiktave dhe kundërthënieve, etj..

Është vërejtur se Kur'ani ka një strukturë mjaft të ndërlikuar matematikore dhe një kod mbrojtës të përkryer që siguron pandryshueshmërinë e tij gjatë gjithë shekujve. Kur'ani i shenjtë dallohet gjithashtu edhe për një muzikalitet të brendshëm.

Pra, Kur'ani në çdo aspekt është mrekulli. Është i tillë sepse ai, në dallim nga librat e mëparshëm hyjnorë, e ka ruajtur pacenueshmërinë dhe pandryshueshmërinë e vet qysh nga

momenti i shpalljes dhe do ta ruajë derisa të ekzistojë kjo botë.

Lexues të nderuar, dua te sqaroj se përkthimi i këtij libri është bërë drejtpërdrejtë nga videokaseta e dokumentarit televiziv: "Ai, Kurani, është i vërtetë " (në mars 1995), dhe fillimisht pikësynimi i vetëm ka qenë futja dhe transmetimi i tij në TVSH (që u realizua në maj 1997).

Desh Allahu që gjatë përgatitjeve për botimin e këtij libri, të më bie ne dorë edhe teksti origjinal në gjuhën arabe "*Innehul-hak*", i doktor Abdul Mexhid Zendani, prej të cilit shkëputa parathënien si edhe fotografitë ilustruese të këtij libri.